VLERAT E TRASHËGIMISË NATYRORE TË KOSOVËS

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Prishtinë
2005

4

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

ME RASTIN E 30 VJETORIT TË THEMELIMIT :

FALENDERON TË GJITHË ATA QË ME PUNËN E TYRE KANË NDIHMUAR DHE KONTRIBUAR NË RUAJTJEN E NATYRËS SË KOSOVËS NË PËRGJITHËSI DHE NË NGRITJEN PROFESIONALE TË IKMN-SË NË VEÇANTI

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS

VLERAT E TRASHËGIMISË NATYRORE TË KOSOVËS

Në përgatitjen e këtij publikimi morën pjesë:
Ylber Sherifi, Afrim Berisha, Mr.sc. Elez Krasniqi, Nazmi Shkodra, Qenan Maxhuni, Mr.sc. Valbona Dabinovci, Adnan Elshani, Mr.Tafë Veselaj, Riza Hajdari, Hamdi Hoti, Fadil Bajraktari, Halime Hajra, Sami Behrami,

Këshilli redaktues:
Ylber Sherifi (biolog, shef i sektorit për zonat e mbrojtura, IKMN)
Afrim Berisha (biolog, bashkëpunëtor profesional, IKMN)
Mr. Zeqir Veselaj (biolog)
Mr. Elez Krasniqi (biolog, shef i sektorit të Biodiversitetit, IKMN)
Sabit Restelica (ing. i teknologjisë, drejtor i IKMN)
Nazmi Shkodra (jurist, zyrtarë i lartë ligjor, IKMN)
Shefqet Zeka (shef i zyrës për Informim, MMPH)

PËRMBAJTJA

I. HYRJE....9
Parathënie.... 13
Historiku i shkurtër i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës 15
Veprimtaria e IKMN-së.... 19
Veçoritë e përgjithshme gjeografike të Kosovës.... 23

II. VLERAT E MBROJTURA TË TRASHËGIMISË NATYRORE TË KOSOVËS 29
Malet e Sharrit.... 35
Gryka e Rugovës.... 45
Drini i Bardhë.... 47
Mirusha.... 49
Gërmia.... 53
Bifurkacioni i Lumit Nerodime.... 57
Gryka e Lumit Klinë.... 59
Ura e Fshajtë.... 59
Shpella e Gadimes.... 61
Muzeu i Kristaleve në Stantërg.... 65
Trungjet e vjetra.... 67

III. VLERAT E NATYRËS TË PROPOZUARA PËR MBROJTJE..... 71
Bjeshkët e Nemuna.....75
Shpella e Ponorcit..... 85
Shpella e Pjetërshticës.....85
Shpella në Grykë të Rugovës..... 87
Liqeni i Batllavës..... 89
Blinaja..... 89
Trungjet..... 89

IV. BIODIVERSITETI.....93

V. SHTOJCAT.....112
Kategoritë e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura sipas IUCN.....112
Kategoritë botërore të rrezikimit të llojeve 113
Aktet Ndërkombëtare Mjedisore.....115
Kalendari mjedisor.....117

VI. LITERATURA.....118

Hyrje

Shekulli që po e lëmë pas do të mbahet mend për ndryshime të konsiderueshme të ndikimit të njeriut në mjedis, ndikim ky i lidhur përveç tjerash nga ritmi i lartë i rritjes së popullsisë në shkallë botërore dhe revolucionit tekniko- shkencor. Ky i fundit krahas rolit të madh që luajti në zhvillimin e industrisë dhe të ekonomisë botërore, pati edhe ndikime negative në natyrë dhe mjedis. Ngrohja globale, hollimi i shtresës së ozonit, humbja e pyjeve, zhdukja e llojeve dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, kanë ndikuar në masë të madhe në baraspeshën ekologjike të planetës duke dëmtuar funksionimin normal të sajë.
Së këndejmi ruajtja e natyrës dhe vlerave të sajë mbetet njëra ndër sfidat më të mëdha për njeriun në të ardhmen.

Edhe Kosova e cila ndodhet në qendër të gadishullit Ballkanik nuk ka qenë jashtë këtyre ndikimeve. Territori i sajë me përbërje natyrore shumë komplekse me zona kodrinore, kodrinore-malore e fushore, të përshkuar nga lumenj është shumë tërheqës për studiues dhe vizitorë. Me bukuritë e rralla, vlerat burimore dhe estetike natyrore si dhe diversitetin biologjik të llojeve bimore dhe shtazore, territori i Kosovës është nga më të veçantit në Gadishullin Ballkanik dhe më gjerë.

Në publikimin "Vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës" janë prezantuar të dhënat themelore për vlerat më reprezentative natyrore të Kosovë, të mbrojtura dhe të propozuara për mbrojtje. Vlerat e mbrojtura të natyrës përfshijnë sipërfaqe prej 46.247.3 ha ose 4.27 % të territorit te Kosovës. Prej tyre një Park Kombëtar, 11 Rezervate të Natyrës, 37 Monumente të Natyrës dhe 2 Peizazhe të Mbrojtura. Nga vlerat më përfaqësuese të natyrës së Kosovës përmendim: Parku Kombëtar Malet e Sharrit, Shpella e Mermertë në Gadime, Kanioni i Mirushës, Parku i Gërmisë, Bifurkacioni i Lumit

Nerodime, Gryka e Rugovës etj.
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës si institucion qendror për ruajtjen e natyrës, monitoron gjendjen e vlerave të mbrojtura dhe njëkohësisht evidenton vlera të reja natyrore me rëndësi të veçantë. Deri më tani janë evidentuar rreth 200 sosh, në mesin e të cilave një Park Kombëtar, disa peizazhe të natyrës dhe shumë monumente natyre me karakter speleologjik, botanik, hidrologjik. Me shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna për Park të dytë Kombëtar dhe me marrjen nën mbrojtje të zonave të propozuara, sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura do të rritej ndjeshëm (rreth 10 % e territorit të Kosovës).
Ruajtja dhe menaxhimi , rritja e numrit dhe sipërfaqes së zonave të mbrojtura si dhe aplikimi i koncepteve mbi shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës në harmoni me trendët ndërkombëtare, janë synime të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Prishtinë, 2005

Introduction

The century that we let beyond, we will remind it for substantial differences of human influences in the environment. This influence is linked, expect with the others also with population increase in the world level, and with technical- science revolution. This revolution in comparison with its big importance's has indicated in the industrial and economic world development, but it has also negative influences in the environment. Global heating, dilution of ozone coating, forestry disappearances, disappearances and utilities in un-controlling way of nature recourses, has indicated in ecological equilibration of the planet and harming the normal function of it.

Therefore, nature protection and its values stay one of the biggest challenges for the human in the further.

In addition, Kosovo, which is in the Ballkan center, it was not outside of these indications. Kosovo territory with its nature structures, lot of complex of hilly areas, hilly-mountains and fields of river flows, it is very interesting for visitors and explorers. With it's rarely beauty's, recourse values and nature aesthetics also biodiversity of vegetative and animal species, the Kosovo territory its one of the most special in the Ballkan Peninsula and in broadly too.

In publication "Values of Nature Legacy of Kosovo", presented are the essential data's for nature-represented values in Kosovo that are protected and proposed for protection.
The values of nature protection includes the surface of 46.247.3 ha or 4.27 % of Kosovo territory. From those one is National Park, 11 Nature Reservoirs, 37 Nature Monuments, and 2 Protected Landscapes. From the most represented nature values in Kosovo we mention the : National Park "Malet e Sharrit", Marble Cave in Gadime, Mirusha Canyon, Germia Park, Bifurcation of River Nerodime, Gryka e Rugoves (Rugova Gap), etc.

The Kosovo Institute for Nature Protection, as a central institution for nature conversation supervise the conditions of protected values and in the same time obvious the new nature values with especial importance's. Until now evidenced are 200 such of this, within which is one National Park, some nature landscapes and lot of nature monuments with speologyc character, botanical and hydrologic. With declaring the "Bjeshket e Nemuna" as a Second National Park and with taking under protection the proposed areas, the general surface of protected areas, increase in the insensitive way (around 10 % of Kosovo territory).

The aim of Kosovo Institute for Nature Protection and the aim of the Ministry of Environmental and Spatial Planning are the protection and management, raising the surface number of protected areas ad concept applying for nature sustainable utilization in harmony with international trends.

Prishtina, 2005

Natyra është një komoditet të cilës i përkasim dhe nuk është një komoditet që na përket

Vlerat e trashëgimisë natyrore janë thesar i një populli, ndërsa përkujdesja ndaj tyre e tregon në përgjithësi nivelin kulturor dhe shoqëror të atij populli. Një popull pa trashëgimi vështirë se mund të gjej vend në mes të popujve të civilizuar të botës.

Zhvillimi i një shoqërie bazohet në një tërësi zhvillimesh të lidhura direkt dhe indirekt, të cilat do të përmblidheshin në tri grupe kryesore: kërkesat ekonomike, kërkesat sociale dhe kërkesat mjedisore.

Deri në dy deceniet e fundit të shekullit të kaluar, në botë kërkesat ekonomike kanë mbizotëruar ndaj kërkesave sociale dhe atyre mjedisore. Ky raport ka filluar të ndryshojë në drejtim të një baraspeshimi të këtyre tri shtyllave bazë të zhvillimit të qëndrueshëm, duke parë ndikimet negative të këtij procesi, siç janë: ngrohja globale, ndryshimet klimatike, dëmtimi i shtresës së ozonit, acidifikimi etj. Kjo paraqet edhe bazën e konceptit të zhvillimit të qën-



drueshëm në botë që u iniciua në Samitin e Rio-s më 1992 dhe të konfirmuar me Samitin e Johanesburgut më 2002.

Kosova ka një trashëgimi të pasur natyrore. Mjafton të përmendësh Parkun e Sharrit, Shpellën e Gadimes, Kanjonin e Mirushës, Bifurkacionin e Nerodimes etj. për të konstatuar se kemi vlera mjaft reprezentative për një vend. Trashëgimia natyrore, ngjashëm me atë kulturore të Kosovës, ka kaluar nëpër sfida dhe rreziqe të shumta në të kaluarën historike. Megjithatë pasojat për trashëgiminë natyrore kanë qenë më të vogla se sa për

trashëgiminë kulturore. Vlerat e trashëgimisë kulturore mund edhe të restaurohen, ndërsa te ato natyrore shumë rrallë mund të ndodh kjo: nëse një monument natyror, një specie bimore ose shtazore zhduket, është e paimagjinueshme që ai të ripërtërihet.
Për dallim nga e kaluara, kur nisur nga motivet politike dhe etnike, natyra dhe vlerat e saj në Kosovë, janë kuptuar si privilegj për t'u shfrytëzuar vetëm nga një spektër i ngushtë i shoqërisë, trendet sot janë duke shkuar që natyra dhe vlerat e saj të jenë të shfrytëzueshme nga e tërë shoqëria. Mekanizmat ligjor dhe institucional të krijuar në Kosovën e pasluftës, mëtojnë të sigurojnë që një gjë e tillë të bëhet në mënyrë të kontrolluar dhe në harmoni me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Vlerat natyrore në Kosovë janë konsideruar si të mbrojtura dhe atë duke bërë të jenë në mënyrë thuaja hermetike të mbyllura, pa e dhënë asnjë mundësi të zhvillimit ekonomik të zonave ku ato shtriheshin. Kjo ka ndikuar dukshëm në pamundësinë e zbatimit të ligjeve, pengimin e përparimit të përgjithshëm të banorëve autokton të zonave, dhe në këtë aspekt me një humbje të konsiderueshme të resurseve ekonomike të vendit në të kaluarën. Kjo praktikë është në fazat fillestare të ndryshimit në Kosovën e pasluftës.

Në politikat e ardhshme, sa i përket mbrojtjes së natyrës, do të mbizotëroj një frymë mjaft e thjeshtë: nuk do të jetë prioritet i yni vetëm që të zgjerohet edhe më tutje sipërfaqja e mbrojtur. Me mbrojtjen e Bjeshkëve të Nemuna si park kombëtar, do të jemi konform standardeve ndërkombëtare, sipas të cilave deri në vitin 2010 rreth 10 % e territorit të jetë e mbrojtur. Mirëpo ajo që është e mbrojtur dhe që do të mbrohet në të ardhmen, do të planifikohet dhe do të zhvillohet në mënyrën sa më efikase të mundshme dhe në pajtim me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Mr. Ardian Gjini
Ministër i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



2. Historiku i shkurtër i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Hapat e parë të mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit në Kosovë fillojnë në fund të viteve të 60, ndonëse iniciativa për mbrojtjen ligjore të vlerave të natyrës ka pasur edhe më herët. Në vitin 1968 formohet njësia për mbrojtjen e natyrës në kuadër të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës.

Me vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, u themelua Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës[1] dhe vazhdoi punën me të njëjtin emër, sipas Ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës [2].

Ndërsa në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerr **ligjin për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut [3]** ku në nenin 78 paragrafi 2 të këtij Ligji është përcaktuar veprimtaria e Entit . Në bazë të këtij **Ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerr Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit [4].**

Pas luftës, me krijimin e rrethanave të reja të qeverisjes në Kosovë, në bazë të Rregullores 1999/1 "i gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë i vihet UNMIK-ut".

Në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së me emërtimin **" Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës"** me seli në Prishtinë.[5]

Në maj të vitit 2000 themelohet Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe në kuadër të tij, inkorporohen dhe veprojnë edhe institucionet ekzistuese: Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës,dhe Drejtoria e Parkut Kombëtar "Malet e Sharrit".

Pas zgjedhjeve të përgjithshme më (2001) dhe formimit të organeve qev-

[1] Vendimi per ndarjen e seksionit për mbrojtjen e natyres ("GZK". 42/74)

[2] Ligji për themelimin e Entit Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës ("GZK". 15/81)

[3] Ligji per Mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut ("GZK" 39/88*)*

[4] Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit ("GZK"nr. 38/89)

[5] nr.i regjistrit të përkohshëm të subjektit Afarist 80156359, data 14.08.00) me emërtim " Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës"



Burimi i Drinit të Bardhë
(Radavc, 2004)

erisëse të Kosovës, formohet edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor [6].

MMPH ndër të tjera është përgjegjëse që: "të krijojë politikën, të zbatojë ligjet dhe të mbikëqyrë aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe resurset e ujit, ajrin, tokën dhe biodiversitetin".

Aktualisht IKMN, vepron në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit.[7]

[6] Formimi I MMPH-se (Rreg. 2001/19 dhe 2002/5).

[7] Ligji per Mbrojtjen e Mjedisit (Rreg. 2003/9).



Peizazh nga Bjeshkët e Nemuna (foto: Fatos Lajçi)



Peizazh dimiri nga Bjeshkët e Nemuna (foto: Fatos Lajçi)

3. Veprimtaria e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Instituti kryen punët e Mbrojtjes së Natyrës me interes për Kosovën si: [8]

1. Përcjellja e gjendjes së Natyrës,
2. Kërkimi, studimi,evidentimi,vlerizimi i natyrës, zbatimi i masave të mbrojtjes të objekteve të natyrës me interes të gjerë, përcaktimi i gjendjes të rrezikimit të tyre dhe marrja e propozimit të masave për ruajtjen dhe zhvillimin e natyrës,
3. Përgatitja e bazës profesionale të propozimeve dhe akteve për marrjen nën mbrojtje të zonave të natyrës,
4. Përcaktimi i kushteve dhe masave për mbrojtjen e natyrës ne procedurën e hartimit të planeve hapësinore e urbanistike ,
5. Përcaktimi i kushteve dhe masave të mbrojtjes së natyrës në procedurën e lejimeve të lejes për ndërtimin e objekteve që prishin ose rrezikojnë natyrën, **dhënia e mendimeve profesionale** organeve kompetente të administratës së Kosovës për kushtet e mbrojtjes së natyrës në procedurën e përcaktimit të kushteve për rregullimin e hapësirës, përkatësisht në planet hapësinore dhe urbanistike,
6. Përgatitja, përkatësisht hartimi i bazave profesionale për mbrojtjen e natyrës, në procedurën e hartimit të planeve hapësinore dhe të programeve të mbrojtjes dhe të zhvillimit të parqeve kombëtare dhe zonave tjera të mbrojtura.
7. Kryerja e punëve të caktuara në zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare të mbrojtjes së natyrës,
8. Mbledhja e të dhënave nga organet dhe organizatat në Kosovë që merren me kërkimin, studimin dhe mbrojtjen e natyre, për programet e punës së tyre në mbrojtjen e natyrës dhe masat që merren për këtë mbrojtje, si dhe për rezultatet e kësaj mbrojtjeje,
9. Planifikimin e punës shkencore kërkimore dhe të punës profesionale në mbrojtjen e natyrës me

[8] Neni 78 paragrafi 2 i Ligjit 39/88



Kanioni i Mirushës
(Mirushë 2005)

interes për Kosovën në kuadër të së cilës realizohet bashkëpunimi i të gjitha organeve dhe organizatave në Kosovë të cilat nxjerrin dhe zbatojnë programet e punës shkencore-kërkimore, i koordinojnë dhe i bashkojnë këto punë, i mbledhin dhe i bashkojnë mjetet i caktojnë përparësitë e kërkimeve dhe të mbrojtjes me qëllim të zhvillimit të tyre racional dhe profesional,

10. Zbatimi i mbikëqyrjes profesionale në realizimin e programeve dhe të masave të mbrojtjes së natyrës nga organet dhe organizatat me interes shtetëror,
11. Mbajtja e regjistrit qendror të zonave të mbrojtura të natyrës,
12. Koordinimi i punës së organizatave që merren me punë profesionale të mbrojtjes së natyrës dhe me dhënien e ndihmës profesionale këtyre organizatave,
13. Informimi i organeve kompetente për gjendjen e mbrojtjes së natyrës dhe propozimi i masave për përparimin e kësaj gjendjeje, si dhe realizimi i bashkëpunimit në këtë lëmi me organet dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare,
14. **Krijimi i sistemit të monitorimit të vlerave të trashëgimisë natyrore në Zonat e Mbrojtura dhe ne përgjithësi për natyrën e Kosovës,**
15. Koordinimi i aktiviteteve në punën kërkimore-shkencore për natyrën dhe sigurimin e pajisjeve bashkëkohore për këto punë,
16. Popullarizimi i veprimtarisë së mbrojtjes së natyrës dhe sensibilizimi i opinionit për vlerat e trashëgimisë natyrore te Kosovës,
17. Kryerja e punëve të tjera të mbrojtjes së natyrës me interes për tërë Kosovën të përcaktuar me ligj.



Bjeshkët e Nemuna (foto: Fatos Lajçi)



Qiellicom
sepse çdo dite llogaritet
KOPAONIKU
SERBIA
NISHI
PROKUPLE
BLLACE
KUSHUMLIA
SOKOLICA
RASHKA
NOVI PAZARI
LEPOSAVIÇI
PESHTERI
TUTINI
MALI I ZI
MOKNA
ZUBIPOTOKU
ZVEÇANI
MITROVICA
BESIANA (Podujeva)
LEBANE
MEDVEGJA
BERANE
ROZHAJA
VUSHTRRI
BURIMI (Istogu)
SKENDERAJ
RRAFSHI
DRENICA
KASTRIOTI (Gjilani)
PRISHTINA
PEJA
KLINA
DRENASI (Gllogovci)
FUSHEKOSOVA
ARTANA (Novobërda)
DARDANA (Kamenica)
PLAVA
DEQANI
LYPIANI
KOSOVES
GJILANI
Termoci
BUJANOCI
MALASI (Malishevo)
SHTIME
FERIZAJ
RAHAVECI
GJAKOVA
THERANDA (Suhareka)
VITI
PRESHEVA
KOSOVA LINDORE
SHQIPTARE
PASHTRIKU
PRIZRENI
SHTERPCI
KAÇANIKU
KUMANOVA
SHQIPERIA
MALI I SHARRIT
KUKESI
SHARRI
TETOVA
SHKUPI
TIRANA
LEGJENDA - LEGEND
Rrugët
1 : 250 000
Autor
Author
© Dr.sc. ing. Murat MEHA
mmeha@yahoo.com
Prishtinë, Prill, 2001.

4. Veçoritë e përgjithshme gjeografike të Kosovës

Pozita gjeografike, madhësia dhe kufijtë

Kosova ka pozitë qendrore gjeografike në Gadishullin Ballkanik që ka rol lidhës në mes të pjesëve veriore e jugore, perëndimore e lindore, por edhe të Evropës Qendrore. Kushtet natyrore të saj janë mjaft të volitshme. Ato e bëjnë Kosovën udhëkryq ndërmjet Adriatikut, Fushës së Panonisë dhe Detit Egje. Kosova shtrihet në mes të 41°50'58" dhe 43°51'42" të gjerësisë gjeografike veriore dhe 20°01'30" dhe 21°48'02" të gjatësisë gjegrafike lindore. Kosova edhe pse një vend i vogël përkah sipërfaqia (10.887 km^2), me 2.1 milion banorë (vlerësim i vitit 1991) dhe me dendësi mesatare prej 192 banor në km^2, paraqet hapësirën më dendësi më të madhe, jo veten në trojet shqiptare, por në tërë Gadishullin Ballkanik.

Kosova kufizohet me: Shqipërinë në jugpërendim dhe perëndim (111.8 km), Malin e Zi në perëndim (78.6 km), Sërbinë në veri dhe në lindje (351.6 km) dhe Maqedoninë në jug (158.7km). Gjatësia e përgjithshe e kufirit të Kosovës me vendet fqinje është afër 700.7 km. Për nga veçoritë natyrore, vija kufitare shtrihet kryesisht nëpër kuota të larta malore.

Emri gjeografik i Kosovës daton që nga koha parahistorike dhe ka origjinë Ilire. Baza e emrit është fjala kos-kas që d.m.th kodër, mal dhe va/va-u që d.m.th. rrafshnaltë.



Malet e Sharrit
(Sharr, 2004)

Përbërja e gjeologjike

Kosova ka një ndërthurje të nderlikuar tektonike dhe përbërje mjaft komplekse gjeologjike. Varësisht nga vjetërsia gjeologjike dhe vetitë fiziko-mekanike të shkëmbinjve, në teritorin e Kosovës dallojmë dy grupe themelore të shkëmbinjve. Shkëmbinjtë e vjetër të erës parakambriane, palezoike dhe mezozoike që dallohen më përbërje kompakte dhe shkëmbinj të ri të erës kenozoike (terciere, kuaternare) me përbërje plastike jo të lidhur. Shkëmbinjtë e vjetër kompakt (rreshpet kristalore, shkëmbinjtë magnetik etj.), ndertojnë malet përiferike dhe në brendi të Kosovës si: Bjeshkjët e Nemuna, Sharri, Koretniku, Pashtriku, Malet e Prugovcit, Zhegovcit, Carralevës, Nerodimës, Berishës etj. Në keto male e sidomos në pjesën lindore të Kosovës, në proceset e ndryshme gjeologjike, janë krijuar pasurit të mëdha minerale metalike edhe jometalike (plumb, zing, krom, nikel etj). Shkëmbinjtë më përbërje plastike (argjilla, argjilla ranore, ranoret etj.), kryesisht mbushin fushgropat e ndryshme në: Kosovë, Dukagjin, Drenicë, Llap, Anamoravë etj. Në këto sendimente janë gjetur sasi të mëdha të linjitit e sidomos në pjesën qendrore të pellgut të Kosovës. Nga aspekti morfologjik Kosova paraqet një mozaik të vërtetë të fushëgropave me dimensione të ndryshme, të përkufizuar me male të mesme e të larta. Lartësia mesatare mbidetare e Kosovës është (810m), kurse pika me e ulët është (270m) e ajo me e larta (2656m) (Gjeravica). Në aspektin hipsometrik sipërfaqe nën 300m lartësi mbidetare përfshinë vetëm 16.4 km^2 (0.2 %) deri 1000 m shtrihen 8754 km^2 (80.7 %), prej 1000 deri 2000 m 1872.3 km^2 (17 %) dhe mbi 2000m deri 250.6 km^2 (2.3 %) Format kryesore në relievin e Kosovës janë: Malet me (63 %) dhe fushëgropat (37%).

Klima

Kosova shtrihet në pjesën jugore të brezit të mesëm gjeografik të gjysmë–sferës veriore dhe i nënshtrohet ndikimeve klimatike mesdhetare-kontinentale dhe evropiane–kontinentale. Makrofaktoret kryesorë klimatikë, të cilet ndikojnë në klimën e Kosovës janë : pozita e saj ndaj masave tokësore (Evroazia dhe Afrika) masat ujore (Oqeani Atlantik dhe Deti Mesdhe) masat e ajrit (tropike dhe arktike-maritine apo kontinentale), pozita e sistemeve barike (maksimumi i azoreve dhe minimumi i Islandës). Faktorët lokal kryesor që ndikojnë në klimen e Kosovës janë: relievi, ujërat, trulli dhe bimësia.

Diellosja (insolacioni) - Është element klimatik i cili ka randësi në veprimtaritë e ndryshme ekonomike (bujqësi, turizëm, mjekësi) etj. Zgjatja e diellosjes varet nga faktorët astronomik, meterologjik dhe nga relievi. Diellosja është më e vogël në luginat e ngushta dhe grykat lumore si dhe në viset malore për shkak të rritjes së vranësirave me rritjen e lartësisë mbidetare. Në bazë të vrojtimeve të diellosjes në katër stacionet metrologjike (Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Pejë), Kosova ka mesatarisht 2.066 orë me diell gjatë vitit ose mesatarisht 5.7 orë në ditë. Vlerën më të madhe të diellosjes e ka Prishtina me 2.140 orë në vit (Tirana ka 2.561 orë) e me se paku Peja me 1.958 orë, Ferizaj 2067 orë dhe Prizreni me 2.099 orë më diell gjatë vitit. Gjatë vitit në muajin korrik ka më së shumti diellosje, kurse në dhjetor më se paku.

Temperatura e ajrit – Është element kryesor klimatik, e cila tregon shkallën e nxehtësisë së ajrit në shtresat pranëtokësore. Në Kosovë vërehen diferenca termike në drejtim horizontal dhe vertikal. Pjesa lindore e Kosovës, Fushëgropa e Kosovës, e Llapit, e Drenicës dhe e Anamoravës janë diç më të ftohta se ana perëndimore, pra Dukagjini. Temperatura mesatare vjetore e Kosovës është 9.5°C. Muaji më i nxehtë është korriku (19.2.°C) kurse muaj më i ftohtë është janari (-1.3°C). Temperatura mesatare vjetore më e larta paraqitet në Prizren (12°C), kurse më të ulëta në Pudujevë (9°C).

Reshjet atmosferike - Në Kosovë paraqiten të gjitha format e reshjeve atmosferike. Randësinë më të madhe e kanë reshjet në formë të shiut nëpër lugina dhe reshjet e borës në viset e larta malore (Bjeshkët e Nemuna dhe Sharr), ku në pjesën lindore të Kosovës, mesatarisht gjatë viti mbi (600 mm) ndërsa në pjesën perëndimore mbi (700 mm) gjatë viti kemi sasira të mëdha të reshjeve në Bjeshkët e Nemuna (1750 mm). Reshjet e borës janë dukuri e rëndomtë në pjesën e ftohtë të vitit. Në pjesët e ulëta të Kosovës mesatarisht paraqiten 26 ditë me reshje bore, kurse në viset malore mbi 100 ditë.

Erënat - Shpejtësia mesatare e erërave në Kosovë oscilon prej 1.3 m/s (në Pejë) deri në 2.4 m/s (në Ferizaj). Shpejtësia maksimale e ernave arrinë 31 m/s dhe zakonisht në muajt mars dhe prill. Në shumë lokalitete në Kosovë erërat kanë emërtime lokale.

Hidrografia

Kosova ka një rrjet hidrografik kryesisht autokton, gjë që shpreh kufijt natyror të saj. Ekziston përputhshmëri mjaft e plotë në mes ujëmbledhësit hidrografik dhe kufijve administrativ-politik. Sipërfaqja ujëmbledhëse topografike e Kosovës është 11,645 km^2 dhe ndaj sipërfaqes administrativo–politike është vetëm për 758 km^2 ose 6.5 % më e madhe. Kosova ka një rrjet të zhvilluar të rrjedhave ujore. Lumenjtë e Kosovës të kushëtzuar nga pozita gjeografike dhe relievi, formojnë një rrjet hidrografik qendërikës dhe u takojnë sistemeve të ndryshme lumore. Ata dallohen si nga numri ashtu edhe nga gjatësia e tyre. Lumenjtë karakterizohen me ujë të bollshëm, duke marr parasysh sasinë e madhe të reshjeve që kjo hapsirë merr gjatë vitit. Si pasojë e tyre kemi një rrjet të dendur hidrografik të përhapur në tërë territorin e vendit. Në pjesët e larta të relievit janë formuar ujëvara, rrjedha të shpejta, gryka, kanione e në pjesët e poshtme terraca të lumit, meandra, moçale etj. Në të gjithë këta lumenjë, karakteristikë themelore është lëkundja e madhe e niveleve dhe e prurjeve të ujit. Lumenjtë e Kosovës e bëjnë gërshetimin e tri ujëndarësve detare të Gadishullit Ballkanik i cili gjindet në perëndim të Ferizajit, në Sukën e Dërmanit (1.364m l.m.d.). Në shpatijet e kesaj suke i kanë pjesët burimore lumi Sitnica, Nerodimja dhe Toplluga të cilët derdhin ujin në dete si (Deti i Zi, Deti Egje dhe Deti Adriatik). Shtrirja e ujëndarësit detar nëpër terrene të ulëta të papërcaktuara, kanë krijuar kushte natyrore për degëzimin (bifukacionin) e ujit dhe paraqitjen e dukurive të bifukacionit si është ai i Nerodimes afër Ferizajt. Lumi i Nerodimes e dërgon ujin në Detin e Zi dhe në Detin e Egje dhe është e vetmja dukuri e këtillë në Evropë. Drejtimi i rrjedhave të lumenjve është zhvilluar në harmoni me format kryesore të relievit. Pjesa më e madhe e lumenjve i takojnë pellgut të Detit të Zi 50,7 % , Detit Adriatik 43,5 % dhe Detit Egje 5,8 %.



Ujvara
e Mirushës
(Mirushë 2005)



Ujvara e Mirushës
(Mirushë 2005)

II. VLERAT E MBROJTURA TË TRASHËGIMISË NATYRORE TË KOSOVËS

Që nga themelimi IKMN si institucion qendror për mbrojtjen e natyrës,ka marrë nën mbrojtje ligjore shumë zona, monumente dhe vlera të tjera natyrore. Deri me sot është marrë nën mbrojtje ligjore sipërfaqja prej 46.247.3 ha ose 4.27 % e territorit të Kosovës. Prej tyre: Parku kombëtar (Malet e Sharrit), 11 rezervate të natyrës (Bifurkacioni i lumit Nerodime, rezervati i Arnenit, Maja e Ropsit, Rusenica, etj.), 37 monumente të natyrës (Shpella e Gadimes, Gryka e Rugovës, Ura e fshajtë etj.) dhe 2 peizazhe të mbrojtura (Gërmia dhe Mirusha). (Tabela 1& 2)

Tab.1
Pasqyra e zonave të mbrojtura në Kosovë

Nr.	Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja (ha)	%
1	**Rezervate të natyrës**	**11**	**698.4**	**1.52**
	R.N. Bimore	6		
	R.N. Shtazore	2		
	R.N.Speciale	3		
2	**Park Kombëtar**	**1**	**39.000**	**84.55**
3	**Monument Natyre**	**38**	**4.867.9**	**10.55**
	M.N. Spelologjike	3		
	M.N. Hidrologjike	8		
	M.N. Gjeomorfologjike	3		
	M.N. Botanike	20		
	M.N. Memoriale	3		
	Muzeu i kristaleve në Stantërg	1		
4	**Pejsazh i mbrojtur**	**2**	**1.681**	**3.17**
	Totali	**52**	**46.247.3**	**100 %**

R.N. - rezervat natyre
M.N. - monument natyre

Grafikoni 1. Numri i zonave të mbrojtura në Kosovë sipas kategorive



Tabela 2. Zonat dhe monumentet natyrore të mbrojtura në Kosovë sipas kategorive, rëndësisë, vendit dhe sipërfaqes

Emërtimi i Zonës/ objektit	Komuna	Sipërfaqja në ha	Viti i mbrojtjes	Kategoria ne Kosove	Kategoria IUCN	Përshkrim i i shkurtër i vlerave
REZERVATET E NATYRËS						
1. Maja e Ropsit	Deçan	20.00	1955	II	I	**Rezervat bimor I llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut**
2. Gubavci	Pejë	38.24	1959	II	I	**Rezervat bimor i llojit endemo-relikt boshtra (*Forsythia europeae)***
3. Popovo prase	Prizren	30.00	1960	II	I	**Rezervat bimor me perberje te paster të munikes- arnenit (*Pinus heldreichii*)·**
4. Gazimestan	Prishtinë	12.00	1953	II	I	**Rezervat bimor I Bozhures (*Paenonia decora Anders)***
5. Kozhnjeri	Deçan	150	1955	II	I	**Rezervat shtazor i llojit dhia e egër (*Rupicapra rupicapra L.)***
6. Oshljaku	Prizren	20	1960	II	I	**Rezervat natyror i arnenit (*Pinus heldreichii*), dhe i disa bimëve endemike**
7. Malet e Prelepit	Deçan	0.92	1963	II	I	**Rezervat bimor me përbërje të pastër të panjës malore *(Acer heildreichii)***
8. Rusenica	Therandë (Suharekë)	300	1955	II	I	***Rezervat shtazor,i rrëqebullit (Lynx lynx L.)…***
9. Bifurkacioni i lumit Nerodime	Ferizaj	120.78,71	1979	II	I	**Rezervat special natyror. Është fenomen unikat në Evropë dhe i dyti në botë me rëndësi të madhe arsimore,shkencore dhe turistike.**
10. Golem bor	Prizren	35,00,00	1960	II		***Rezervat bimor.i llojit të Molikës dhe I disa shpendëve këngëtarë***
11. Kamilja	Albanik (Leposaviq)	227.89	1988	II		**Bregorja gëlqerore Kamilja është Rezervat i veçantë natyror me veçori paleontologjike**
II. PARQET KOMBËTARE						
1. Malet e Sharrit	Prizren, Suharekë, Kaqanik, Shtërpce	39 000	1986	I	II	**Karakterizohen me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Si dhe me rëndësi të madhe turistike**

III. MONUMENTET E NATYRËS							
1.	Shpella e Gadimes	Lypjan	55,00	1969		III	***Gjeomonument i natyrës i pasur me stoli natyrore, është ndër shpellat më të bukura në Kosovë, Ballkan dhe më gjerë me rendësi shkencore, edukative, arsimore dhe turistike .***
2.	Shpella e Bajincës	Drenas	00, 11, 55	1987		III	**Gjeomonument I natyrës me vlera speleologjike dhe hidrologjike**
3.	Shpella në Gllanasellë	Drenas	00, 50, 17	1987		III	**Gjeomonument me karakter gjeomorfologjik, hidrologjik dhe speleologjik.**
4.	Gryka e lumit Bistrica	Prizren	200,00,00	1976		III	**Monument natyror me karakter hidrologjik dhe peizazhor**
5.	Burimi i Drinit të Bardhë me shpellën dhe ujvarën në Radavc	Pejë	00. 89, 94	1983		III	**Monument natyre me rëndësi gjeomorfologjike, hidrologjike dhe turistike.**
6.	Rrjedha e lumit Mirusha	Malishevë, Klinë	10,03,35 1,93,94	1983		III	**Rëndësi hidrologjike dhe peizazhore**
7.	Burimi i ujit mineral në Dresnik	Klinë	6,75	1985		III	**Monument natyror me karakter hidrologjik**
8.	Burimi termomineral në Vuqë	Albanik (Leposaviq)	16, 60, 13	1988		III	**Monument natyror me karakter hidrologjik**
9.	Burimi i ujit në Revuqë	Podujevë	1,16,94	1988		III	**Monument natyror me karakter hidrologjik**
10.	Burimi i ujit mineral në Sallabajë	Podujevë	31,47	1988		III	**Monument natyror me karakter hidrologjik**
11.	Burimi i ujit në Shakovicë	Podujevë	1,40,54	1988		III	**Monument natyror me karakter hidrologjik**
12.	Gryka e lumit Klina	Klinë	1,204,94,4[9]	1985		III	***Monument kompleks I natyrës me vlera gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike***
13.	Gryka e Rugovës	Pejë	4,301,05,49	1985			***Rëndësi gjeologjike, hidrologjike, pejsazhore, speleologjike, botanike***
14.	Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e fshejtë	Gakovë, Rahovec	73,86,47 124,96,09	1986		III	***Monument natyre me rendësi hidro-gjeomorfologjike në kanionin e Drinit të Bardhë***
15.	Rrapi në Marash (Platanus orientalis)	Prizren		1959		III	***Monument natyre me karakter botanik, edukativ, shkencor dhe kulturor...***
16.	Mani Sham (Morus sp.)	Pejë		1957			**Monument natyror me karakter botanik**
17.	Plepi në Bajqinë (Populus tremula)	Podujevë		1959			**Monument natyror me karakter botanik**
18.	Arneni në Nerodime (Pinus Heldreichi)	Ferizaj		1959			**Ish monument natyror me karakter botanik**
19.	Bliri në Isniq (Tilia argentea)	Deqan		1968			**Monument natyror me karakter botanike**
20.	Bliri në Strellc të Epërm (Tilia argentea)	Deqan		1961			**Monument natyror me karakter botanik**
21.	Trungjet e Blirit në Isniq	Deqan		1968			**Monumente natyrore me vlera të ralla botanike**

22.	Vidhi fushor në Lukinaj (Ulmus Campestris)	Prizren		1981		**Ish monument natyror me karakter botanik**
23.	Trungjet e bungut në Lozicë (Quercus sp.)	Malishevë		1985		**Monument I rëndësishëm natyror për hulumtime shkencore me karakter botanik**
24.	Trungu i qarrit në Zllakuqan (Quercus cerris)	Klinë		1985		**Monument natyror me karakter botanik dhe turistik**
25.	Trungu i qarrit në Poterq të ulët (Quercus sp.)	Klinë		1985		**Ish monumet natyror me karakter botanik**
26.	Trungu i vidhit në Qabiq (Ulmus minor Miller)	Klinë		1985		**Ish monument natyror me karakter botanik**
27.	Trungu i qarrit në Bërkovë (Quercus sp)	Klinë		1985		**Ish monument natyror me karakter botanik**
28.	Trungu i qarrit në Dumnicë të poshtme (Quercus cerris)	Podujevë		1988		**Monument natyror me karakter botanik**
29.	Trungu i qarrit në Polatë (Quercus cerris)	Podjevë		1988		**Monument natyror me karakter botanik**
30.	Trungu i plepit në Orllan (Populus tremula)	Podujevë		1988		**Ish monument natyror me karakter botanik**
31.	Trungu i qarrit në Dobratin (Quercus Cerris)	Podujevë		1988		**Monument natyror me karakter botanik**
32.	Maja e zezë	Pejë	112,50,00	1977		**Monument memorial I natyrës**
33.	Ramjani	Viti	190,00,00	1982		**Monument memorial I natyrës**
34.	Cabrati	Gjakovë	64,00,00	1984		**Monument memorial I natyrës**
35.	Mineralet-Kristalet	Stantërg, Mitrovicë		1970		***Minerale dhe kristale të ruajtura në Muzeun e kristaleve në Stan Tërg.***

PEIZAZHET E MBROJTURA						
1. Parku regjional i Mirushës	Klinë, Malishevë, Rahovec	555,80,70	1982, 1983		V	***Kanioni me ujëvarat e njëpasnjëshme dhe peizazhet specifike,paraqet një fenomen të rrallë natyror që ka rëndësi të jashtëzakonshme natyrore,shkencore,kulturore dhe turistike***
2. Parku Regjional Gërmia	Prishtinë	1,126,01,00	1987		V	**Me rendësi të madhe shkencore, edukative, kulturore dhe turistike rekreative.**
PARK PYLLI						
1."Pishat e Deçanit"	Deçan	15	1968		V	**Përbërja e pastër e pishës së zezë te Manastiri i Deçanit**
2. Rahavane	**Suharekë (Therandë)**	**20**	**1980**		**V**	**Projekti "88 trungje"**

HARTA E ZONAVE TË MBROJTURA

MMPH
GIS & IT



MALET E SHARRIT

Prezantojnë zonën kryesore për vlera botanike, faunistike, ekologjike, turistike, rekreative, sportive, edukative dhe kulturore të Kosovës. Malet e Sharrit kanë diversitet biologjik mjaft të theksuar. Flora dhe vegjetacioni është i pasur me lloje. Në mesin e këtyre llojeve 86 sosh, janë të deklaruara me rëndësi ndërkombëtare, 26 lloje janë të përfshira në "Listën e Kuqe" Evropiane të shtazëve dhe bimëve si të kërcënuara dhe 32 janë në "Listën e Kuqe" të bimëve të kërcënuara sipas IUCN - it. Duke u bazuar në këto fakte mund të konsiderohet si qendër e jetesës së llojeve diversitare të Ballkanit dhe Evropës.

Një pjesë e Maleve të Sharrit është shpallur Park Kombëtar në vitin 1986. Zona e mbrojtur me ligj ka sipërfaqe prej 39 000 ha dhe shtrihet në kufijtë e katër komunave [9]: Prizren, Shtërpcë, Therandë dhe Kaçanik.

Sipas IUCN (Unionit botëror për Ruajtjen dhe Konservimin e Natyrës) Parku Kombëtar Malet e Sharrit është evidentuar në listën ndërkombëtare të zonave të mbrojtura.[10]

Gjeomorfologjia – Në formimin morfologjik të Sharrit kanë ndikuar lëvizjet tektonike të tokës me çka janë krijuar ngjeshje gjeomofologjike, gjithashtu edhe me forca të jashtme të cilat kanë pasur ndikim në akullnaja, rrjedha të ujit etj. Si rezultat i veprimeve akullnajore janë krijuar thellësira të cilat janë shndërruar në liqene akullnajore siç janë Liqeni i Livadhit, liqeni i Jazhincës dhe liqenet tjera mjaft atraktiv të cilët në popull njihen si "Sytë e maleve." Në përbërjen gjeologjike të Sharrit marrin pjesë shkëmbinjtë e periudhës paleozoike, shkëmbinjtë gëlqeror, të mermertë etj.

Klima – është nën ndikimin e klimës kontinentale me dimra të gjatë dhe reshje të mëdha të dëborës dhe verëra të freskëta. Si shkak i kësaj klime, temperaturat e ajrit janë më të ulëta për 10 – 15 ^{0}C se sa në fushat e Kosovës. Kjo klimë ofron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit si gjatë dimrit ashtu edhe të stinëve të tjera.



Burim ujor nga Malet e Sharrit (Sharr, 2004)

[9] Parku Kombëtar "Malet e Sharrit" shtrihet në territorin e komunave: Prizren (19.500 ha), Shtërpcë (15.210 ha), Therandë (2.730 ha) dhe Kaçanik (1.560 ha).

[10] IUCN (1990), United Nations List of National Parks and Protected Areas.



Malet e Sharrit
(Sharr, 2004)

Hidrologjia – Si rezultat i reshjeve të shumta atmosferike, regjioni i Parkut Nacional të Sharrit është jashtëzakonisht i pasur me ujëra që përfshijnë një numër të madh të liqeneve me origjinë glaciale, burime dhe rrjedha të disa lumenjve. Territorit të maleve të Sharrit i takojnë derdhjet e dy lumenjve, Lepenci dhe Lumëbardhi i Prizrenit. Lepeci krijohet me bashkimin e ujë-rrjedhave që burojnë nga malet e Cerevcit dhe Jezercit e në rrjedhën e vet pranojnë degë të shumta. Lumëbardhi i Prizrenit buron në rajonin e Prevallës i cili gjithashtu mbledh shumë degë të pasura me ujë.
Në territorin e Maleve të Sharrit janë 25 liqene në lartësi mbidetare mbi 1900 m. të cilët përfaqësojnë vlerat e veçanta natyrore të Masivit të Sharrit. Liqeni më i madh është Liqeni i Livadhit (2173 m.)
Peizazhet - karakterizohen me vlera të llojllojshme natyrore. Tërësinë atraktive peizazhore e përbëjnë pyjet, kullosat, livadhet të shoqëruara me degëzime të relievit shpesh të krijuara nga prerjet e luginave nëpër të cilat kalojnë lumenj dhe përroska, vende – vende në formë të kanioneve dhe grykave me ujëvara apo liqene, duke pasqyruar përjetim të këndshëm të kësaj natyre të bukur.

Pastori Ilir autokton nga Sharri

Flora, vegjetacioni dhe fauna

Nga aspekti floristik këto male hyjnë në radhën e maleve më të pasura të Kosovës dhe Gadishullit Ballkanik dhe paraqesin një thesar të specieve bimore ku janë prezent një numër i madh i llojeve bimore endemike dhe reliktesh, duke përfshirë edhe llojet bimore të rralla dhe të rrezikuara. Deri tani në këto male janë konstatuar afro 2000 lloje bimore dhe 68 bashkësi bimore.
Në kuadër të vegjetacionit pyjor hasim lloje të ndryshme të dushkut, ahut, bredhit, hormoqit, pishës së bardhë, pishën endemike dhe relikte të maleve të larta: Arneni (Pinus heildreichii) dhe molika (Pinus peuce), panja endemike malore (Acer heildreichii), lisi i rëndomtë (Taxus baccata), çetinaku (Pinus mugo), rododendroni (Rhododendron ferrugineum) etj.





Malet e Sharrit
(Prevallë, 2004)

Përveç vegjetacionit pyjor, si komponentë më e rëndësishme e vlerave natyrore të këtij territori, vend të rëndësishëm zë edhe vegjetacioni i livadheve dhe kullosave.
Territori i Sharrit me biotopet e ndryshme është shumë i pasur në pikëpamje faunistike. Në të janë prezent lloje të veçanta të shtazëve të cilat ekskluzivisht janë të lidhura për biotope specifike që dmth. se përhapja e tyre është e ngushtë. Ndërsa llojet e tjera që hasen në biotope të ndryshme janë të përhapjes së gjerë.
Fauna e Sharrit dhe në përgjithësi Mali Sharr, deri sot nuk është hulumtuar sa duhet, mirëpo në bazë të të dhënave të literaturës mund të konstatohet se fauna e Sharrit është mjaft e pasur.
Në pyjet e larta të Sharrit jetojnë llojet e rëndësishme të gjitarëve siç janë ariu i murrmë (Ursus arctos), rrëqebulli (Lynx lynx), kaprolli (Capreollus capreolus) etj. Gjithashtu në këto male gjejnë kushte të volitshme për folenizim edhe lloje të shumta të shpendëve siç është shqiponja e maleve (Aquila chrysaetos) pastaj lloje të tjera të familjes së grabitçarëve si dhe shumë lloje të tjera të grupit të këngëtarëve. Për shkak të pasurisë ornitofaunistike Malet e Sharrit janë të evidentuara në listat ndërkombëtare si Regjione të rëndësishme ornitofaunistike (IBA-Region).

Grafikoni 2. Llojllojshmëria e kurrizorëve të lartë në Malet e Sharrit





Peizazh dimëror nga Malet e Sharrit (Sharr, 2003)

Zonat me vlera të veçanta në kuadër të maleve të Sharrit

Brenda territorit të Parkut Nacional Malet e Sharrit ekzistojnë zona me vlera të veçanta natyrore si: Koxhaballkani (Pisha e madhe), Oshlaku (Arneni), Maja e Arnenit(Prevallë) ,
Maja e zezë (Bistra), Gropa e Madhe, Liqeni Glacial (akullnajor) i Livadhit etj.

Në kuadër të Maleve të Sharrit, gjenden edhe lokalitete me specifika të veçanta natyrore, siç janë:
Luboteni - maja më e lartë e Maleve të Sharrit (2496 m). Është karakteristike se përbërja gjeologjike e tij është kryesisht gëlqeror, që dallohet nga malet tjera zinxhirore me përbërje gjeologjike nga silikati. Deri tani janë konstatuar 649 lloje të bimëve vaskulare të grupuara në 81 familje dhe 21 asociacione bimore. Në kuadër të florës së Lubotenit gjenden edhe lloje të rralla dhe të kërcënuara.

Gryka e Dulës - është e pasur me ujëvara dhe me lloje të ndryshme të bimëve të rralla drurore, siç janë : Acer heildreichii, Sorbus aucuparia, Ulmus glabra, Pinus peuce etj.

Tabela 3. Vlerat e mbrojtura natyrore në kuadër të Sharrit

Zona/ objekti	Sipërfaqja në ha	Viti i vënies nën mbrojtje	Rëndësia e mbrojtjes	Kategoria e mbrojtjes
Maja e arnenit (Prevallë)	30	1960	Rëndësi botanike me llojin e ruajtur të pishës (*Pinus heildreichi*), rëndësi ornitofaunistike për llojin pula e egër *(Tetrao urogallus*) dhe rëndësi të madhe turistike, rekreative dhe mjekësore.	I Rezervat bimor
Koxhaballkani (Pisha e madhe)	30	1960	Rezervat natyror i arnenit (*Pinus heldreichii*) dhe çetinaku (*Pinus mugo)*.	I Rezervat bimor
Oshlaku	20	1960	Rezervat i arnenit (Pinus heldreichi), po ashtu me rëndësi ornitofaunistike.	I Rezervat bimor
Rusenica	300	1955	*Rezervat shtazor, vendbanim I llojit të Rrëqebullit (Lynx lynx L.)*	I Rezervat shtazor


ZONAT E MBROJTURA NË PARKUN NACIONAL "MALET E SHARRIT"
Rusenica
Pashallar
Klisyra
Luboteni
Gollem Bor
Oshlak
Liqenet e Livadicës
Mali i Arnenit
Prroni i Durlovit
Livadhet e Mbretit & Liqeni i Jazhincës
Lumi Bukova
N
0
2
4
kilometers
LEGJENDA
Gollem Bor
Klisyra
Kobilica
Liqenet e Livadicës
Livadhet e Mbretit & Liqeni i Jazhincë
Luboteni
Lumi Bukova
Mali i Arnenit
Oshlak
Pashallar
Prroni i Durlovit
Rusenica

Livadhi i Mbretit – **Liqeni i Jazhincës -** shtrihet në pjesën shkëmbore të Maleve të Sharrit nën majen e Bistrës. Është i gjatë 120 m, i gjerë 80 m dhe ka thellësi 10 m. Në këtë lokalitet gjenden këto bashkësi bimore: Fagetum Montanum, Sescerio - Pinetum heldreichii, Ajugo - pinetum peucis, ndërsa në pjesët më të larta: Rhododendron – Pinetum peucis, lloji Dëllinja (Juniperus sp.)etj, ndërsa në pjesën e epërme: Ranunculetum - Cerenati, Potentillo doerfleri - Juncetum trifidi dhe Carex laevis - Sesleria comosa.

Lumi i Bukuruvaqës - lokacion i bukur me peizazhe interesante dhe shumë atraktive për vizitorët. Këtu ka një numër të madh të bimëve të rralla dhe autoktone si: Pinguicula ballkanica, Alyssum sardicum, Crocus Sardicus, Anemone relics – narcissifolia, Draba doerfleri etj.

Ostrovica – këtu gjendet bashkësia bimore: Ptillotricho bruckenthalio – Pinetum mughi). Vlenë të përmenden llojet Bornmuellera diecki dhe Cerastium neoscardicum, si bimë autoktone të këtij vendi. Pyjet me arnen (Pinus heldreichii) përfaqësojnë një shembull të rrallë të bashkësisë pyjore në Siujdhesën Ballkanike e cila së bashku me ahun, i jep një pamje të veçantë këtij lokacioni.

Vlerat turistike, kulturore, shkencore dhe edukative të Maleve të Sharrit

I tërë territori i maleve të Sharrit ka vlera të rëndësishme natyrore dhe estetike. Karakteristikat e ndryshme dhe specifike të elementeve të veçanta të mjedisit natyror dhe lidhja ndërmjet tyre ofron kushte të veçanta të pushimit, edukimit dhe rekreacionit.
Studimet e shumta, dhe projektet turistike tregojnë se në territorin e maleve të Sharrit, ekzistojnë shumë mundësi të zhvillimit të aktiviteteve turistike, rekreative e sportive, gjatë verës dhe dimrit. Atraksionet natyrore dhe afërsia e regjionit me zonat e popullara, mundëson zhvillimin e formave të ndryshme të turizmit në këtë territor. Kushtet gjeografike dhe klimatike të këtij territori nxisin dhe përkrahin shfrytëzimin rekreativ të zonës për aktivitete vjetore. Kushtet e volitshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive, rekreative, etj ofrojnë mundësi të mira për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror.



Gryka e Rugovës (2004)

GRYKA E RUGOVËS

Gryka e Rugovës paraqet pjesën më piktoreske të Bjeshkëve të Nemuna, karakterizohet me shkëmbinj të lartë gëlqeror të prerë nga Lumëbardhi i Pejës, me numër të madh të shpellave si dhe me lloje bimore, relikte dhe endemorelikte.

Gryka e Rugovës është marrë nën mbrojtje si monument natyre në vitin 1988. Ka një sipërfaqe prej 4301,05,04 ha.
Sipas **IUCN** (Unionit Botëror për Ruajtjen dhe Konservimin e Natyrës), Gryka e Rugovës si Monument Natyre është evidentuar në listën ndërkombëtare të zonave të mbrojtura[11]

11 IUCN (1990) United Nations List of National Parks and Protected Areas



Motive nga Vallja e Rugovës



Burimi i Drinit
të Bardhë
(Radavc, 2004)

DRINI I BARDHË

Burimi i Drinit të Bardhë me shpellën dhe ujëvarën në Radavc - janë marrë nën mbrojte prej vitit 1983, si monument natyre. Zona e mbrojtur kap një sipërfaqe prej 89.94 ha dhe
është burimi më i fuqishëm i ujit në Kosovë me 5m^3 ujë ne sekond.



Burimi i Drinit të Bardhë
(Radavc, 2004)



Ujvarat nga Mirusha
(Mirushë, 2004)

MIRUSHA

Rajoni i Mirushës është një ndër rajonet më të bukura dhe më interesante të natyrës së Kosovës. Këtë e dokumentojnë të dhënat për diversitetitn biologjik në këtë rajon. Ky rajon ka sipërfaqe prej 63.21 km^2. Lartësia mbidetare e rajonit sillet prej 340 - 1006 m. Lumi Mirusha është një ndër lumenjtë më të bukur të Kosovës. Ai në pjesën përfundimtare të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i lumit Mirushë. Parku natyror i Mirushës gjendet në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha që nga fillimi i kanionit deri gati në derdhjen e tij në lumin Drini i Bardhë. Ndodhet në territorin e komunave Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Nga Prishtina është larg 65 km. Lartësia mbidetare e Parkut sillet prej 340 - 600 m. Sipërfaqja e territorit të mbrojtur të Parkut Regjional të Mirushës është 556 ha. Përgjatë territorit të Parkut të Mirushës kalon lumi Mirusha i cili gjatë rrjedhës së tij krijon 13 ujëvara dhe 16 liqene të cilët së bashku krijojnë një fenomen të rrallë morfo-hidrologjik, tepër atraktiv për vizitorë. Liqeni më i madhë është liqeni i 16 (55m X 45m) me thellësi 5m. Ky është liqeni më i vizituar nga vizitoret ngase është pjesa më e afërt dhe më e lehtë për vizitë. Ujëvara më e lartë është ajo në mes të liqenit 8 – 9, gjatësia e së cilës është 21m. Klima e rajonit të Mirushës është e butë kontinentale e ndikuar nga klima mesdhetare.

Flora, vegjetacioni dhe fauna

Është mjaft i pasur me lloje dhe bashkësi bimore e shtazore. Pjesa më e madhe e rajonit i takon bashkësisë së bungut (**Ass. Querrcetum farnetto - cerris scardicum Krasniqi 1968**) që në të vërtetë është një ndër bashkësitë më të përhapura pyjore në Kosovë. Në territorin e Parkut të Mirushës gjenden 330 lloje të bimëve vaskulare, duke mos i llogaritur bimët e ulëta dhe myshqet. Nga bimët e ulëta janë evidentuar 44 specie kërpudhash të larta (makromicetesh), ndërsa në territorin e gjerë të rajonit të Mirushës janë prezente 838 taksone bimore të përfaqësuara me 590 lloje të bimëve vaskulare. Veçanti e florës së rajonit të Mirushës është prania e 14 bashkësive (asociacioneve) bimore, 5 prej të cilave kanë karakter endemik, ndërsa numri i llojeve endemike është 21. Prej tyre lloji **Aristolochia merxmuelleri** është lloj stenoendemik dhe deri tani në nivel botëror është konstatuar vetëm në këtë rajon në disa lokalitete relativisht të ngushta.



Peiezazh nga rrjedha
e Lumit Mirushë

Bashkësitë bimore në rajonin e Mirushës janë:

1. Ass.: Salicetum albae fragilis Soo (1930, 1934) 1958,
2. Ass.: Salicetum purpurea Wendbg.,
3. Ass.: Alnetum glutinosae s. lat.,
4. Ass. Querrcetum farnetto - cerris scardicum Krasniqi 1968,
5. Ass. Polygalo – Genistetum hassertianae Blec. et Krasn. 1969 (endem.),
6. Ass. Polygalo – Forsythietum europaea Blec. et Krasn. 1971 (endem.),
7. Ass. Onosmo – Scabietosum fumaroides Rexhepi 1978 (endem.),
8. Ass.: Hyperico – Euphorbietum glabriflorae Rexhepi 1978,
9. Ass. Potentillo – Fumanetum bonapartei Rexhepi 1979 (endem.),
10. Ass.: Echinario – Convolvuletum althaeoides Rexhepi 1979,
11. Ass.: Salvio – Scorsoneretum villosae Hundozi 1980,
12. Ass.: Quercetum pubescentis – cerris Rexhepi 1985,
13. Ass. Astero – Juniperetum Oxycedri Rexhepi 1990 (endem.) dhe
14. Ass.: Vitici – Tamaricetum dalmaticae H –ic 1960 (Rexhepi 1994).

Prej llojeve endemike janë konstatuar llojet endemike të Ballkanit, të Kosovës dhe Shqipërisë, ndërsa llojet endemike të Kosovës janë:
Aristolochia merxmuelleri,
Malus florentina,
Aster albanicus,
Moltkia doerfleri ,
Armeria rumelica,
Polygala doerfleri,
Centaurea albertii,
Potentilla visianii,
Centaurea kosaninii,
Sanguisorba albanica,
Forsythia europaea,
Scabiosa fumaroides,
Fumana bonapartei,
Scutelaria orientalis,
Genista hassertiana,
Sedum serpentini,
Halacsya sendtneri,
Stipa mayeri, dhe
Knautia macedonica,
Veronica andrasovszkyi.
Linum elegans,

Fauna – Në rajonin e Mirushës janë vërejtur këto lloje të shtazëve: derri i egër (Sus scrofa), vjedulla (Meles meles), lepuri (Lepus europaeus), ketri (Scirius vulgaris), ujku (Canis lupus), maca e egër (Felis silvestris), Sqarthi (Martes Martes), miu bizam (Ondatra zibethica), miu i verdhë malor (Apodemus flaviocollis), iriqi (Erinaceus concolor L.), breshka e tokës (Testudo sp.). gjarpëri helmues i gurit (Vipera amodytes). etj. Përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha ekzistojnë kushte të volitshme për jetën e ujëtokësorëve dhe peshqve.



Zona rekreative në Gërmi (Gërmi, 2004)

GËRMIA

Masivi malor i Gërmisë paraqet një pasuri natyrore shumë të rëndësishme jo vetëm për Prishtinën, por edhe për tërë Kosovën.

Shtrihet në verilindje të kryeqendrës së Kosovës (Prishtinës) dhe përfshinë një sipërfaqe prej **62 km^2**. Kufijtë e Gërmisë fillojnë prej kodrës së vreshtave në perëndim, pastaj në lindje të Prishtinës përmes **kodrës së Mirditës** deri te **xeherorja e Hajvalisë** e deri te **rrjedha e lumit të Graçanicës,** kufiri jugor shkon përmes rrjedhës së këtij lumi deri te derdhja e **lumit të Busisë** në të. Në lindje kufiri shtrihet përmes lumit të Busisë deri te fshati **Mramor e Butovc** e pastaj deri te **lumi i Prishtinës** i cili është kufiri verior i këtij masivi malor. Pika më e lartë e Gërmisë është **maja e Butovcit** me lartësi mbidetare prej **1050 m**.
Relievi i Gërmisë përbëhet prej kodrave me lartësi dhe pjerrësi të ndryshme të ndara mes tyre me hapësira të luginave të përrockave dhe lumenjve. Këtu posaçërsiht veçohet lugina e lumit Vellusha e cila buron në pjesën perëndimore të kodrës së Butovcit, e cila edhe përfaqëson relievin më karakteristik me lartësi mbidetare 1000 m dhe gjatësi prej afro 8 km. Kjo pjesë shtrihet në mes të lumit të Prishtinës në veri dhe atij të Badocit në jug, e që njëkohësisht paraqet nyjen hidrologjike të lumit të Prishtinës, Vellushës dhe Badocit. Përndryshe në Gërmi ekzistojnë edhe mjaft burime të cilët gjatë periudhës verore pjesërisht thahen. Sot uji i këtyre burimeve është i lidhur me një rrjetë që derdhet në pishinën e Gërmisë.

Pasuria floristike, vegjetative dhe faunistike e Gërmisë

Në sajë të pozitës gjeografike, veçorive gjeologjike, pedologjike, kushteve klimatike etj. masivi malor i Gërmisë është mjaftë i pasur si në pikëpamje floristike, vegjetative dhe faunistike.
Nga hulumtimet e deritashme janë të evidencuara 610 lloje të florës vaskulare të grumbulluara në 82 familje dhe 83 lloje kërpudhash duke mos llogaritur taksonet e barërave të këqija, atyre ruderale dhe bimëve tjera të ulëta. Prej tyre 5 lloje janë endemike dhe 12 lloje mjekësore.
Vegjetacionin pyjor të Gërmisë e përbëjnë 4 bashkësi pyjore:
Bashkësia e shpardhit dhe çarrit (Quercetum frainetoo cerris scardicum Kras.), prej 600-700 m lartësi mbidetare,
Bashkësia e bungut dhe shkozës (Querco Carpinetum moesiacum) 800 m,
Bashkesia e bungut (Quercetum moesiacum



Peizazh nga Gërmia

montanum) 820- 870 m dhe
Bashkësia e ahut (Fagetum moesiacum montanum) në lartësi mbidetare prej 800 - 950 m.
Kompleksiteti i biotopeve natyrore të Gërmisë siguron kushte për jetesën e një sërë llojesh shtazore. Sipas hulumtimeve të bëra deri më sot dhe sipas shënimeve të literaturës në regjionin e Gërmisë jetojnë 5 lloje ujëtoksorësh, 7 lloje të rrëshqitësve, 30 lloje të shpendëve dhe 19 lloje të gjitarëve. Po ashtu jetojnë edhe një numër i madh i insekteve që përbëjnë grupin më të madh të shtazëve në këtë masiv.

Parku i Gërmisë, vend i rekreacionit dhe i pushimit

Mbi 75 % e sipërfaqes së Parkut të Gërmisë është e mbuluar me bashkësi të shpardhit, çarrit, bungut dhe ahut. Një pjesë të rëndësishme të sipërfaqes së mbrojtur e përfshin edhe zona për rekreacion dhe pushim, në të cilën gjenden livadhet dhe infrastruktura tjetër.
Në kuadër të territorit të mbrojtur gjendet edhe zona për rekreacion dhe pushim, me sipërfaqe 41.40.52 ha, e cila fillon prej pishinës e mëtutje në brendi të Gërmisë, duke përfshirë livadhet, ish pushimoren e fëmijëve, terrenet sportive, ish hotelin e Gërmisë e deri te fillimi skiliftit.

Kjo zonë është e rrethuar me pyje të dushkut dhe të ahut, me pamje atraktive dhe është e dedikuar për pushim dhe rekreacion.
Statusi i ligjor i Gërmisë - Për shkak të bukurive të posaçme natyrore, vlerave burimore dhe estetike natyrore të cilat janë me rëndësi kulturore - arsimore, shkencore dhe turistiko - rekreative kësaj zone i është kushtuar edhe nje përkujdesje e veçantë ligjore. Në vitin 1987 Kuvendi Komunal i Prishtinës merr Vendim për vënien nën mbrojtje të Kompleksit **"Gërmia"**(**1.126.01.00 ha)** në kategori të Parkut regjional natyror.
Sipas **IUCN** (Unionit Botëror për Ruajtjen dhe Konzervimin e Natyrës), Parku i Gërmisë është evidentuar në listën ndërkombëtare të zonave të mbrojtura.[12]

[12] IUCN (1990) United Nations List of National Parks and Protected Areas





Bifurkacioni i lumit Nerodime
(Nerodime e ulët, 2004)

BIFURKACIONI I LUMIT NERODIME

Bifurkacioni i Lumit Nerodime paraqet një shembull të vetëm në Evropë të derdhjes së një lumi në dy detra, ku së bashku me lumin Orinoko në Amerikën Jugore, paraqesin dy raste të vetme në botë.
Lumi buron në Bjeshkët e Jezercit dhe formohet prej dy degëve kryesore të cilat bashkohen në fshatin Nerodime dhe vazhdon rrugëtimin deri te penda, ku ndodh bifurkimi i pare. Bifurkacioni i Lumit Nerodime ndahet pakthyeshëm në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme. Dega veriore (dega e majtë) derdhët në lumin Sitnicë dhe vazhdon rrugëtimin në lumin Ibër, Moravë dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi, ndërsa dega jugore (dega e djathtë) së pari bashkohet me njërën degë të lumit Nerodime e cila ndahet tek penda e betonit (një distancë 1300 m) dhe së bashku vazhdojnë rrugëtimin në lumin Lepenc dhe përmes Vardarit derdhet në Detin Egje .
Ky kuriozitet natyror është mjaft tërheqës për studiues dhe vizitorë dhe ka rëndësi të madhe edukative, shkencore dhe turistike. Që nga viti 1979 është vënë nën mbrojtje ligjore si rezervat special i natyrës. Sipërfaqja e mbrojtur është 12.78,71 ha.



Harta e Bifurkacionit te lumit Nerodimes



Biufurkacioni i lumit Nerodime (Nerodime e ulët, 1971, foto arkiva e IKMN-së)



Gryka e Lumit Klinë

Gryka e lumit Klina, është monument natyror me vlera gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike. Është vënë nën mbrojtje në vitin1985, sipërfaqja e mbrojtur është 205 ha.

Ura e Fshajtë

Ura e Fshajtë në kanionin e Drinit të Bardhë, është monument natyre me karakter hidro-gjeomorfologjik me sipërfaqe prej 199 ha dhe shtrihet në territorin e komunës së Gjakovës (73.86 ha) dhe Rahovecit (124.96 ha).

Është vënë nën mbrojtje në vitin 1986. Lumi Drini i Bardhë gjatë një procesi të gjatë gjeomorfologjik hapë një grykë në mes dy shkëmbinjve gëlqeror dhe formon një kanion shumë tërheqës dhe interesant për studiues dhe për vizitorë.



Ura e Fshajtë
(Fshaj, 2004)



SHPELLA E GADIMES

Shpella e Mermertë në Gadime të Ulët është një ndër shpellat më të bukura jo vetëm në Kosovë por edhe në Ballkan dhe më gjerë.
Në Shpellën e Gadimes paraqiten të gjitha llojet e stolive karakteristike për shpellat. Më së shumti ka stalagmite dhe stalaktite që paraqiten në të gjitha pjesët e shpellës, në forma dhe madhësi të ndryshme. Ato janë formuar gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të shpellës dhe gati të gjitha janë aktive edhe në etapën e tashme. Shtyllat masive të kalcitit paraqiten vetëm në galerinë veriore. Këto shtylla të shkurtra kanë trashësi gati 1 m dhe kryesisht lidhen me shkrirjet në formë kupe. Këto shkrirje janë formuar mbi kupa të përbëra prej deltinës së shpellës. Për këtë paraqiten në të gjitha pjesët e shpellës. Ato kanë forma të ndryshme, por më tepër dallohen perdet me formë gjuhe të dhëmbëzuar që i përngjasin sharrës. Basene cërmoku ka në të gjitha shkrirjet, por janë me dimensione të vogla. Në numër mjaftë të madh



Shpella e Gadimes
(Gadime e ulët, 2004)



Shpella e Gadimes (Gadime 2004)

janë të pranishëm edhe zbukurimet e tejdukshme në formë gypash me trashësi cigareje dhe gjatësi deri 3 m. Këto janë stolitë më të reja të shpellës.
Posaçërisht tërheq vëmendjen stolia aragonite. Nuk ekzistojnë shpella në botë të kenë kaq stoli aragonite dhe në kaq forma të shumëllojshme. Kanali i aragonitit në Galerinë veriore është rast unikat. Plafoni i tij është mbuluar me gërshetim aragonit kristalesh të formave të ndryshme me ngjyrë të bardhë dhe të kaltër të cilët i ngjajnë rrjetës së shpeshtë të merimangës. Disa kristale prej tyre janë të orientuar në të gjitha drejtimet, të lakuar dhe me thyerje brrylore me gjatësi deri 30 cm. Në xhepa, në zbrazëtira të vogla e të mëdha në plafon, gërshetimet e kristalit argonit zëvendësohen me " iriqë" të stolisur me gjilpëra shumë të gjata kristali. Ngjyra e stolive në Shpellën e Mermertë është e shumëllojshme dhe e niansuar. Mbizotrojnë zbukurimet e ngjyrës së bardhë-verdhë, si psh. Stalaktitet dhe stalagmitet e Sallës së margaritarëve. Ndërsa kemi edhe stalaktite të bardha të ngjashme me miell që mbarojne me frytëza të kuqërremëta. Ngjyrë të bardhë kristali apo ngjyrë të bardhë në të kaltërt, kanë edhe zbukurimet në formë "cigare"- gypëza të bardhë e të biruar. Perdet kanë ngjyrë të kaltërt në të bardhë ose në të verdhë, duke përjashtuar Korridorin e kaltërt, në të cilin paraqiten zbukurime të shpellës në të kaltër. Kjo shpellë është vënë nën mbrojtje menjëherë pas zbulimit me 29 korrik 1969. Ndërsa në vitin 1982 është marrë vendimi i ri me vënien në mbrojtje të Shpellës si gjeomonument me vlera të posaçme të natyrës.
Sipërfaqja e mbrojtur e shpellës është 56,25,02 ha (në pronësi shtetërore 36,34,88 ha dhe pronësi private 19,91,04 ha).

Përveç shpellës së Gadimes ekzistojnë edhe shpella të tjera të cilat janë vënë nën mbrojtje siç janë shpella në Shkabaj, Qëndresë dhe në Radavc.





Kristalet e Trepçës
(Stantërg, 2004)

MUZEU I KRISTALEVE NË STANTËRG

Muzeu i kristaleve në Stantërg është një koleksion i mineraleve dhe kristaleve me rëndësi të posaçme, që nga të tjerat dallohen për nga përbërja, pamja, ngjyra etj.

Muzeu i kristaleve është marrë nën mbrojtje në vitin 1969. Ai është ndërtuar në vitin 1963 ndërsa për vizitorë është hapur më 1965 dhe është nën përkujdesje të minierës " Trepça " prej ku janë nxjerrë edhe kristalet.

Në muze janë të ekspozuara 1.150 ekzemplarë që prezantojnë mese 51 lloje të ndryshme të kristaleve si: vivijan, kuarc, kalcit, pirit, pirotinë, sfalerit, galenit, plumozit dhe shumë të tjera që janë të vlefshme dhe paraqesin një thesar të vërtetë. Në muze janë të ekspozuara edhe shumë ekzemplarë të tjerë të kristaleve dhe mineraleve nga vendet e tjera si dhe mjete pune dhe kristale të shekullit të XIV nga miniera e Artanës (ish Novobërda), kristale nga Meksika, kripë kuzhine të konservuar nga Gjermania etj.



Kristalet e Trepçës (Stantërg, 2004)



Rrapi - *Platanus Orjentalis*
(Marash, 2004)

TRUNGJET E VJETRA

Rrapi i Marashit (Platanus orientalis) në Prizren - Ndodhet në bregun e lumit Bistrica në krahun e djathtë të aksit rrugor Prizren-Shtërpcë. Është vënë nën mbrojtje ligjore me 1959 (sipërfaqja e mbrojtur 0.5 ha). Supozohet se trungu ka vjetërsi mbi 200 vjeçare. Perimetri i kurorës së tij është mbi 18 m ndërsa gjerësia e bazës është 2.70 m. Njihet si njëri prej trungjeve më të vjetra, më dekorativ dhe më karakteristik në Kosovë dhe ka rëndësi shkencore, kulturore, edukative, peizazhore, rekreative dhe ekonomike.

Trungu i Qarrit (Quercus cerris) në Dobratin - Monument natyror me karakter botanik është vënë nën mbrojtje ligjore në vitin 1987. Gjendet në vendin e quajtur "Bumellt" në fshatin Dobratin. Zona e mbrojtur ka sipërfaqe prej 25 m.

Trungu i Qarrit (Quercus cerris) në Zllakuçan- Është Monument Natyre me karakter botanik dhe turistik (1985). Gjendet në oborrin e kishës së fshatit Zllakuçan. Trungu është i gjatë mbi 20 m ndërsa diametri i trungut është 1. 50 m. Është ekzemplar i rrallë dhe interesant për hulumtime shkencore.

Trungjet e Bungut në Llazicë - (1985). Katër lisa me dy rrënjë gjenden në vendin e quajtur " Te ara nën shpi" në fshatin Llazicë të Malishevës. Supozohet se këto trungje janë më të vjetër se 200 vjet dhe paraqesin objekt të rëndësishëm natyror për hulumtime shkencore. Njëri trung ka lartësi 11 m dhe kurorë rreth 20 m ndërsa tjetri lartësi 19 dhe gjerësi të kurorës 15 m.



Trungu i qarrit (Quercus cerris) (Zllakuqan, 2004)



Trungjet e Bungut
(Llazicë, 2003)

Trungu i Blirit (Tilia argentea) në Isniq, monument natyre (1968).
Trungu gjendet në vendin e quajtur " Te Breja" në fshatin Isniq të Deçanit. Është i lartë 21 m dhe ka diametër 1.89 m. Supozohet se ky trung është i vjetër rreth 450 vjet dhe si i tillë paraqet një raritet natyror me karakter botanik.

Trungjet e blirit (Tilia argentea) në Isniq - Janë futur nën mbrojtje ligjore në vitin 1968. Në kompleksin e lisave gjenden 11 trungje të cilët ndodhen në varrezat e fshatit Isniq në vendin e quajtur " Varrezat e Ibërdemajve". Trungjet janë në gjendje të mire natyrore dhe paraqesin vlerë të rrallë botanike për hulumtime shkencore.



Trungje të propozuara për mbrojtje

Binqë, Viti (2005)



Peizazh nga Bjeshkët
e Nemuna (2004)

III. VLERAT E NATYRËS TË PROPOZUARA PËR MBROJTJE

Gjatë periudhës 1999- 2004 Instituti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës - ka bërë evidentimin e vlerave të reja të natyrës. Njohja dhe evidentimi i vlerave të reja të natyrës është kryer në 12 komuna edhe atë në: Gjakovë, Skenderaj, Drenas, Burim, Rahovec, Kastriot, Vushtrri, Gjilan, Malishevë, Mitrovicë, Klinë dhe Podujevë. Gjatë këtij procesi janë evidentuar 206 vlera të reja që mund ti përkasin kategorive të ndryshme menaxhuese.(Tabela 4.)

Gjatë punës së tij të gjatë, punës së tij të mëhershme, IKMN ka evidentuar edhe vlera të tjera të rëndësishme të natyrës siç janë: Mokna, Pashtriku, Koritniku, Çyçavica, të cilët ende nuk kanë status të mbrojtjes.

Po ashtu gjatë vitit 2002- 2003 në IKMN është punuar studimi për arsyeshmërinë e shpalljes së Bjeshkëve të Nemuna Park Kombëtar. Deri më tani propozimet e IKMN-së për marrjen nën mbrojtje të vlerave me rëndësi të veçantë natyrore kanë hasur në përkrahje nga disa komuna (Burimi, Kastrioti, Skenderaj, Drenasi, etj), të cilat i kanë marrë këto objekte nën mbrojtje të përkohshme (63 objekte), ndërsa në disa komuna tjera (Malishevë, Gjilan, Gjakovë,Podujevë, etj) propozimet e IKMN-së për marrjen e vlerave natyrore nën mbrojtje, janë në procedim (143 objekte).

Me shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna (62 000 ha) Park të dytë Kombëtar si dhe me marrjen nën mbrojtje të vlerave të tjera të propozuara (206 objekte), sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura do të rritej dukshëm, nga 4,27 % në 10 % të sipërfaqes Kosovës.

Grafikoni 3. Kronologjia e mbrojtjes së natyrës në Kosovë sipas viteve





Majat e larta malore të Alpeve Shqiptare (2004)

Tabela 4. Numri i vlerave natyrore të mbrojtura, të propozuara për mbrojtje dhe shtrirja e tyre sipas komunave

Komuna	Zonat e Mbrojtura	Rezervat natyre	Park Kombëtar	Monument natyre	Park pylli	Peizazh i mbrojtur	Zonat e propozuara për mbrojtje
1. Deçan	**8**	3		4	1		
2. Dragash (Sharr)							
3. Ferizaj	**2**	1		1			
4. Fushë Kosovë							
5. Gjakovë				2			**28**
6. Gjilan							**14**
7. Gllogoc (Drenas)	**2**			2			**10**
8. Istog (Burim)							**17**
9. Kaçanik	**1**		1[13]				
10. Kamenicë (Dardanë)							
11. Klinë	**9**			6		1[14]	**5**
12. Leposaviq (Albanik)	**2**	1		1			
13. Lypjan	**1**			1			
14. Malishevë	**2**			1		1[14]	**13**
15. Mitrovicë				1			**4**
16. Novobërdë (Artanë)							
17. Obiliq-Kastriot							**6**
18. Pejë	**6**	1		5			
19. Podujevë (Besianë)	**8**			8			**9**
20. Prishtinë	**2**	1				1	
21. Prizren	**7**	3	1[13]	3			
22. Rahovec	**3**			2		1[14]	**7**
23. Shtërpcë	**1**		1[13]				
24. Shtime							
25. Skenderaj							**13**
26. Suharekë (Therandë)	**3**	1	1[13]		1		
27. Viti	**1**				1		
28. Vushtrri							**17**
29. Zubin Potok							
30. Zveçan							

13 Parku kombëtar "Malet e Sharrit" shtrihet në territorin e katër komunave (Prizren, Therandë, Shtërpcë dhe Kaçaniku)

14 Parku i Mirushës shtrihet ne territorin e tri komunave (Klinë, Malishevë dhe Rahovec)



Vegjetacion halor në
Bjeshkët e Nemuna

BJESHKËT E NEMUNA

Bjeshkët e Nemuna për nga përbërja gjeologjike, gjeomorfologjike, floristike dhe faunistike paraqesin masivin më të rëndësishëm dhe më interesant jo vetëm të Kosovës, por edhe të tërë Gadishullit Ballkanik. Bota e gjallë e Bjeshkëve të Nemuna (e shprehur përmes florës, vegjetacionit, faunës etj) është e begatshme dhe e llojllojshme, para se gjithash nga fakti se edhe bota jo e gjallë është gjithashtu e begatshme. Begatshmëria e botës së gjallë është rezultat i proceseve historike si dhe evolucionit gjatë të cilit Bjeshkët e Nemuna, për shkak të pozitës jugore në Evropë, por dhe vet siujdhesën Ballkanike (pra si rajon submesdhetar) gjatë kohës së akullnajave



Liqeni i madh në Bjeshkët e Nemuna (Foto: Fatos Lajçi)



Motiv nga Bjeshkët e Nemuna
(Foto: Fatos Lajçi)

nuk ka qenë të atakuara nga të ftohtit dhe akullnajat në masë të madhe si në Evropën Veriore dhe të Mesme. Si të tilla këto bjeshkë kanë qenë rajon i rëndësishëm refugjial që ka mundësuar që shumë lloje bimore e shtazore të ruhen në këtë masiv malor. Se Bjeshkët e Nemuna i ka përfshirë koha e akullnajave, e veçmas majat dhe pjesët e mesme të tyre, dëshmojnë mbetjet e periudhës glaciale, siç janë shumë liqene glacial ndër të cilët më të njohur janë ata të Leqinatit (2000 m), liqenet e Gjeravicës (2350 m), Ridit (1970 m) etj.
Bjeshkët e Nemuna përfshijnë pjesën perëndimore dhe veri-perëndimore të Dukagjinit e cila është vazhdim i maleve prej Liqenit të Shkodrës, Plavë e Guci deri në luginën tektonike të Ibrit. Ato me masën e tyre në pjesën lindore dhe juglindore lëshohen deri në Pejë, Deçan dhe Gjakove. Bjeshkët e Nemuna janë vazhdim i sistemit të maleve Dinarike dhe bëjnë pjesë në sistemin e maleve të reja të cilat kryesisht kanë përbërje prej shkëmbinjve gëlqeror-dolomit të cilët të shumtën e rasteve mbërrijnë trashësinë edhe deri në 1000 m. Këto male me majat e larta të thepisura hyjnë në radhën e maleve më të "egra" jo vetëm të vendit tonë, por edhe të Evropës.
Në këtë sistem malor dallojmë mbi 9 maja të larta mbi 2000 m: Gjeravica (2656 m), Koprivniku (2377 m), Negjinati (2341 m), Malet e Lumëbardhit (2335 m), Zhlebi



Bjeshkët e Nemuna



(2352 m), Rusolija (2381 m), Hajla (2400 m), Mokna (2155 m), Kozhnjeri (2154 m) etj.
Lartësia mesatare e Bjeshkëve të Nemuna kalon mbi 1600 m, ndërsa lartësitë e këtyre maleve në pikëpamje strukturale janë të përbëra prej shkëmbinjve gëlqeror të strukturave të ndryshme, ku mbizotërojnë shkëmbinjtë e mezozoikut të cilët mbështeten mbi formacionet paleozoike. Në të gjenden format e ndryshueshme të cilat janë të krijuara nga proceset fluvioglaciale, e si pasojë e të cilëve është formimi i grykave të thella. Në këto male mjaftë është i shprehur erozioni, për shkak të përbërjes strukturale të tokës dhe reshjeve të mëdha që bën shpëlarjen e shkëmbinjve.

Sa i përket klimës ajo në kuptimin makroklimatik dhe rajonal është variant e ndërlikuar e tipit mesdhetar, përkatësisht submesdhetar, por në lartësitë e mëdha ajo është krejtësisht tjetër, përkatësisht në variantin klimatik polar dhe subpolar. Ky gërshetim i klimës ka krijuar një kompleks të ndërlikuar të kushteve ekologjike të cilat kanë qenë edhe parakusht për paraqitjen dhe ekzistencën e florës dhe faunës së begatshme dhe të shumëllojshme.

Flora, vegjetacioni dhe fauna

Territori i Bjeshkëve të Nemuna shquhet për shumëllojshmëri biologjike e peizazhore, falë pozicionit gjeografik, kushteve gje-

Grafikoni 4. Llojllojshmëria e kurrizorëve të lartë në Bjeshkët e Nemuna





Burimi i ujit natyral rrëzë Bjeshkëve të thata në Burim (Istog)

ologjike, pedologjike, hidrologjike dhe karakteristikave të relievit e të klimës. Relievi i thyer dhe vertikaliteti i theksuar ofrojnë kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri të madh llojesh bimore dhe shtazore. Në Bjeshkët e Nemuna, sipas shumë studimeve, gjenden mbi 1500 lloje bimore, shumë prej tyre janë lloje relikte si: Acer heildreichii, Asyneuma trichocalicinum, Campanula lingulata, Cardamine glauca, Castane sativa, Cotinus coggigria, Edrianthus graminifolius, Edrianthus tenuis etj.

Në territorin e Bjeshkëve të Nemuna, 19 lloje kanë statutin e mbrojtjes së plotë si: Pinus peuce, Pinus mugho, Pinus heildreichi, Taxus baccata, Alnus viridis, Quercus trojana, Spirea canea, Acer heildreichii, Acer intermedium,

Tabela 5. Vlerat e mbrojtura natyrore në kuadër te Bjeshkëve të Nemuna

Zona/ objekti	**Sipërfaqja në ha**	**Viti i vënies nën mbrojtje**	**Rëndësia e mbrojtjes**	**Kategoria e mbrojtjes**
Maja e Ropsit	25	1955	Rëndësi botanike me llojet e rujatur të molikës, bredhit, pishës dhe ahut	I Rezervat bimor
Kozhnjari	161	1955	Rendësi faunistike, rezervat ku jeton dhia e egër (*Rupicapra rupicapra L.)*	I Rezervat shtazor
Malet e Prilepit	0.92	1963	Rëndësi botanike,përbërje e paster e panjës malore *(Acer heildreichii)*	I Rezervat bimor
Gubavci	38	1959	Rëndësi botanike, jeton lloji endemo-relikt boshtra (*Forsythia europeae)*	I Rezervat bimor
Gryka e Rugovës	4301	1988	Rëndësi gjologjike, hidrologjike, pejsazhore, speleologjike, botanike	III Monument natyre
Burimi i Drinit të Bardhë me shpellën dhe ujvarën në Radavc	89.94	1983	Rëndësi hidrologjike, pejsazhore, gjeologjike, speleologjike	III Monument natyre



Bjeshkët e Nemuna
(Foto: Fatos Lajçi)

Daphne laureola, Forsythia europea, Gentiana lutea, Wulfenia carinthiaca, Ramonda serbica, Succisa pratensis, Leontopodium alpinum, Lilium martagon, Dactylorhiza cordigera dhe Dactylorhiza majalis.
Gjithashtu ekzistojnë edhe 31 lloje të bimëve që e kanë statusin e llojeve pjesërisht të mbrojtura, gjegjësisht kontrollit në qarkullim, ndërsa të propozuara dhe të radhitura në Listën e Kuqe janë 41 lloje bimore.
Nga llojet endemike dhe joendemike të florës, në European Red List UNESCO New York 1991, janë 4 lloje: Viola elegantula, Sempervivum macedonicum, Ramonda serbica, Narthecium scardicum.
Bjeshkët e Nemuna dhe Kosova në përgjithësi, nga aspekti faunistik i përkasin rajonit Hollarktik, përkatësisht nënrajonit Euro-Siberian. Karakterizohet me një faunë mjaft të pasur, heterogjene, endemike dhe interesante. Kjo pasuri faunistike e Bjeshkëve të Nemuna, si masivi më i madh në Ballkan, është si rezultat i ndikimeve të shumëta të regjionit mesdhetar, eurosiberian dhe atij nordiko-alpin si dhe ndryshimeve të shpeshta të kushteve ekologjike në të kaluarën.
Në territorin e Bjeshkëve të Nemuna gjenden lloje te gjitarëve dhe shpendëve që janë mjaft të rralla për rajonin e Ballkanit dhe më gjerë, shumë prej tyre janë relikte, endemike, të kërcënuara nga zhdukja dhe për këtë arsye gjenden në listat dhe në librat e kuq ndërkombëtar.
Bjeshkët e Nemuna ofrojnë kushte të volitshme për jetesën e llojeve të rëndësishme të gjitarëve të mëdhenj, si ariu i murrmë (Ursus arctos), rrëqebulli (Lynx lynx), kaprolli (Capreolus capreolus), dhia e egër (Rupicapra rupicapra). Territori i Bjeshkëve të Nemuna është i evidentuar si rajon me rëndësi të madhe ornitofaunistike (IBA Region). Po ashtu këtu folenizojnë shumë lloje të shpendëve të cilët janë me rëndësi për ornitofaunën e Kosovës dhe më gjerë. Llojet më reprezentative janë: shqiponja perandorake (Aquilla heliaca), shqiponja e maleve (Aquilla chrysaetos), fajkoi thonjëbardhë (Falco naummani), petriti (Accipiter gentilis), pulëegra (Tetrao urogallus) si dhe shumë shpendë e gjitarë të tjerë që kanë status të mbrojtur kombëtar dhe ndërkombëtar.
Deri më tani ekzistojnë disa zona të mbrojtura në kuadër të Bjeshkëve të Nemuna, ato janë të klasifikuara në kategorinë e rezervateve strikte të natyrës, rezervateve të natyrës, përmendoreve natyrore dhe parqeve memoriale.
Bjeshkët e Nemuna njihen për tradita të pasura kulturore**.** Bukuritë natyrore dhe raritetet, veshja karakteristike, doket dhe zakonet, vallja e Rugovës etj. paraqesin dhe janë vlera të rralla kulturore, joshëse për çdo vizitor.



Shpella e Panorcit
(Panorc, 2003)

Shpella e Panorcit

Shpella e Panorcit gjendet në pjesën jugore të fshatit Panorc të Malishevës , respektivisht në shpatijet veriore të malit Okovan (977 m).
Hyrja në shpellë ka ekspozicion verior dhe gjendet në lartësi mbidetare rreth 580 m. Shpella është zhvilluar në gëlqerorët me rudiste të kretasikut të sipërm dhe është e predisponuar nga elementet litologjike dhe tektonike. Disa metra nën hyrje të shpellës ekzistojnë dy burime ujore të cilët sipas të gjitha gjasave, janë në lidhshmeri hidrologjike me shpellën. Në shpellë ka rjedhje të përhershme me oscilime të theksuara të prurjeve ujore. Pjesa e hulumtuar e shpellës karakterizohet me zbrazëtira (boshllëqe) karstike me dimensione të konsiderueshme, por jo edhe me begati të veçanta të stolive speleologjike. Në dyshemenë e kanalit vërehen depozitime të konsideruara të zajeve me përbërje litologjike heterogjene. Kjo shpellë është në procedurë për vënje nën mbrojtje.

Shpella e Pjetërshticës

Në fshatin Pjetërshticë (KK. Shtime) në kodrën e quajtur Suka e Vogël, ndodhet shpella e pahulumtuar e cila sipas disa veçorive është e ngjashme me Shpellën e mermertë në Gadime.
Shpella në Pjetërshticë u zbulua me 2 shtator të vitit 2003, nga një grup fëmijësh të këtij fshati. Shpella ka pamje shumë të bukur me plot kristale dhe shkëlqim, duke filluar nga hyrja. Ndërtimi gjeologjik i kodrës Suka e Vogël ku është zbuluar shpella, është shumë i ndërlikuar. Terreni është i përbërë kryesisht nga serpentinet, ku në disa vende kemi



Shpella e Panorcit (Panorc, 2001)



Shpella në Grykë të Rugoves

serpentinite shumë të ndryshuara. Në këtë kodër ndodhet një pjesë e cila është e ndërtuar nga rreshpet argjillore. Duke vazhduar rrugën përreth kodrës Suka e Vogël, vazhdimisht ka ndërrime të shkëmbinjve, rreshpe argjillore me ngjyra të ndryshme dhe me shkallë të ndryshme të shkatërrimit.
Në mes rreshpeve janë gëlqerorët të cilët janë zbuluar vetëm në pjesën ku është edhe hyrja e shpellës, ndërsa sa vazhdon kjo seri e gëlqerorëve dhe në cilin drejtim vazhdon, për momentin nuk është e hulumtuar.
Shpella e Pjetërshticës është në procedurë për vënje nën mbrojtje.

Shpella e Grykës së Rugovës

Shpella gjendet në Grykën e Rugovës në shpatijet e anës së djathtë të lumit Lumbardh i Pejës. Shpella gjendet në lartësi mbidetare 740 m. Pas hyrjes shpella vazhdon me një kanal i cili ka një zhvillim të madh vertikal dhe është i paradisponuar nga një çarje tektonike. Supozohet se kjo shpellë paraqet një objekt speleologjik me rendësi të veçantë shkencore dhe turistike.
Përveç shpellave të përmendura më lartë, kemi edhe një numër shpellash të tjera të zbuluara me vlera të rralla natyrore (shpella e Bresalcit etj)



Detaj nga Shpella e Pjetërshticës



Liqeni i Batllavës
(Batllavë, 2004)

Liqeni i Batllavës

Kompleksi i liqenit të Batllavës shquhet për bukuritë natyrore të gërshetuar nga liqeni, pyjet dhe peizazhi që e rrethon me sipërfaqe 220 km^2. Pyjet që e rrethojnë liqenin arrijnë lartësinë mbidetare, prej 800- 1000 m.
Liqeni i Batllavës paraqet një vend mjaft atraktiv për zhvillimin e ekoturizmit.
Liqeni është i krijuar artificialisht me 1959, me qëllim të shfrytëzimit të ujit për pije.

Blinaja

Territori i Blinajës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, 15 km në perëndim të qytetit të Lypjanit. Sipërfaqja e Blinajës është 5500 ha dhe shtrihet në territorin e tri komunave: Lypjan, Shtime dhe Drenas. Lartësia mbidetare është prej 670 – 860 m. Prania e 33 liqeneve dhe 60 livadheve krijon peizazhe të bukura dhe të ndryshme të cilat e bëjnë Blinajën shumë atraktive dhe tërheqëse për studiues dhe vizitorë dhe njëherit ofron kushte të volitshme për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore.

Trungjet

Gjashtë lisat në Likoshan (Quercus sp.), monument natyre i propozuar për mbrojtje. Me rëndësi të madhe botanike është për faktin se nga një rrënjë janë zhvilluar gjashtë trungje, por edhe me vlerë historike.
Ekzitojnë edhe shumë trungje, burime ujore, shpella, peizazhe të natyrës dhe vlera tjera të rralla natyrore të propozuara për mbrojtje .



Liqeni i Batllavës
(1973, Arkiva e IKMN-së)



Gjashtë lisat në Likoshan



Peizazh nga Blinaja



Shqiponja e maleve
Aquila chrysaetos
(Sharr 2005)

IV. BIODIVERSITETI

Biodiversitetit është një nocion shumë kompleks që nënkupton tërësinë e llojeve dhe ekosistemeve në një rajon apo në gjithë globin, ose shprehur ndryshe biodiverziteti paraqet llojllojshmërinë jetësore në tokë. Termi biodiversitet përbëhet nga dy fjalë bio–jetë dhe diverzitet – ndryshueshmëri. Jeta e gjallë në tokë ka nivele të ndryshme të diverzitetit duke filluar nga ADN-ja , llojet, popullacioni dhe ekosistemi.

Ndonëse Kosova është një vend i vogël, shquhet për një biodiversitet të pasur. Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor. Këto rrethana kanë krijuar kushte të favorshme për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri të konsiderueshëm të llojeve relikte, endemike dhe subendemike si dhe të llojeve me rëndësi të veçantë.

Biodiversiteti në Kosovë ka disa veçori të cilat e dallojnë nga vendet tjera, duke e bërë interesant për hulumtues vendor dhe të huaj[15]. Jo rrallë hulumtues të huaj[16] kanë ardhur në ekspedita të ndryshme në natyrën e Kosovës dhe janë kthyer në vendet e tyre me material i cili ka rezultuar me lloje të reja për shkencë.

Krahasuar me sipërfaqen që ka Kosova (afër 2.3%) në kuadër të Gadishullin Ballkanik mund të vijmë në një përfundim relativ dhe të themi se biodiversiteti i Kosovës është i mirë. Sa për ilustrim po e përmendim vetëm një shembull: Deri me tani në Parkun Kombëtar Malet e Sharrit janë evidentuar më shumë se 2000 lloje të bimëve vaskulare. Prej numrit të përgjithshëm të llojeve të evidentuara në Malet e Sharrit, 86 lloje janë shpallur ndërkombëtarisht të rëndësishme, 26 lloje janë të përfshira në Listën e Kuqe të Evropës, ndërsa sipas IUCN-së, 32 lloje që gjinden ne Malet e Sharrit janë në Listën e Kuqe të Bimëve të kërcënuara. Ndërsa vetëm në zonën subalpike dhe alpine të Alpeve Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna) janë evidentuar 797 lloje te bimëve vaskulare, ku 128 prej tyre konsiderohen me karakter endemik (Millaku, F.1999).

Hulumtime të mirëfillta intensive nga hulumtues vendor[17] janë realizuar sidomos pas viteve 1960, pasi që fillon themelimi i institucioneve arsimore – shkencore.

Kjo ka rezultuar me definimin e një numri të përafërt të llojeve bimore dhe shtazore. Me këtë rast vlenë të përmenden faktet se në hebariumin e FSHMN-së ndodhen mbi 1000 lloje bimore[18] dhe një numër relativ i

[15] Mendohet në të kaluarën e largët (Periudha glaciale), kushtet klimatike, përbërja gjeologjike, kushtet hidrologjike etj.

[16] Javorkae, S. 1922 etj; Grisebach, A. 1844 etj.; Visiani, R. 1847 etj.; Kosanin, N. 1914 etj.; Rudski, I. 1934 etj.; Degen , A. 1901. etj.; Hayek, A. 1914 etj.; Sendtner, O. 1848 etj.; Wettstein, R. 1918 etj.; Pançiq, J. 1887 etj.; Witasek, J. 1909 etj., etj.; Greuter , W. & Mayer, E. 1985; Wraber, T. 1986.

[17] Krasniqi, F.; Dauti, E.; Rexhepi, F.; Hundozi, B.; Gecaj, A.; Millaku, F.; Pajazitaj, Q.; Hoxha, E., Gashi, A.; Krasniqi, E.; Mustafa, B.; Veselaj, Z. etj.

[18] Numër i konsiderueshëm i llojeve bimore ndodhen në pronësi private të hulumtuesve të ndryshëm.

Tabela 6. Disa lloje endemike karakteristike për Kosovë

1.	Achillea alexandri – Regis Bornm. et Rud. 1934. *(Barpezmi i mbretit Aleksandër)*
2.	Aconitum pentheri Hauek 1916. *(Akoniti i Rusolisë)*
3.	Aristolochia merxmuelleri Greuter et Mayer 1985. *(Petriku i Grojterit)*
4.	Bornmuellera dieckii Deg. 1900. *(Bornmulera e Degenit)*
5.	Centaurea albertii Rexhepi 1980. *(Kokoçeli i Albertit)*
6.	Cephalaria pastricensis Dorfl. et Hayek. 1921. *(Cefalaria e Pashtrikut)*
7.	Convolvulus cochlearis Griseb. 1844. *(Dredhja e Kosovës)*
8.	Cynoglossum krasniqii 1986. *(Gjuhëqeni i Krasniqit)*
9.	Dianthus scardicus *(Karafili i sharrit)*
10.	Micromeria albanica (Griseb. ex K. Maly) Silic. 1979. *(Bishtmiu shqiptar)*
11.	Plantago dardanae Rexhepi et Dimov. 2001 *(Plantago dardane)*
12.	Potentilla doerfleri Wettst. 1892. *(Zorrëca e Dorflerit)*
13.	Rubus ipecensis rech. 1935. *(Manaferra e Pejës)*
14.	Sedum flexuosum (Rrushqyqja e epshme)
15.	Sempervivum kosaninii Praeger 1930. *(Burgulli i Koshaninit)*
16.	Saxifraga scardica (iriqëza e sharrit)
17.	Stipa mayer Mart. 1971. *(Pendëkaposhi i Mayerit)*
18.	Thymus doerfleri (*Zhumbrica e Dorflerit*)
19.	Thymus rochlenae (*Zhumbrica*)
20.	Verbascum scardicolum Bornm. 1922. *(Barpeshku i Sharrit)*

Grafikoni 5. Spektri floristik i llojeve bimore të Sharrit me status ndërkombëtar të mbrojtur



bimëve të ulëta dhe i shtazëve të konservuara në lokalet e FSHMN-së.
Në vazhdimësi janë hulumtimet për bimët e ulëta, për të cilat ende nuk mund të flasim me shifra.
Hulumtime më intensive janë realizuar në fushën e studimeve floristike dhe vegjetative. Në bazë të hulumtimeve të vazhdueshme në këto fusha, deri tani dihet për inventarizimin e mbi 1000 llojeve të bimëve vaskulare, ndërsa supozohet që ky numër duhet ta kalojë shifrën 2.500 lloje[19].
Prej këtij fondi të mirë të llojeve të bimëve vaskulare, në territorin e Kosovës gjenden rreth 200 lloje të cilat kanë karakter endemik, ku me shumë se 12 prej tyre janë stenoendemike. Disa nga llojet stenoendemike, nga ekipet e IKMN–së, janë vizituar gjatë viteve 2001 – 2004, dihet gjendja e tyre dhe ndodhen të herbarizuara në herbariumin e IKMN-së.
Numër i konsiderueshëm i llojeve bimore janë të rralla por edhe të rrezikuara, kur merren parasysh faktet se numër i konsiderueshëm i llojeve bimore të këtij fondi floristik janë të përfaqësuara me lloje me areal të ngushtë, duke mos i lënë anash llojet mjekësore dhe aromatike.
Vlerësimi i gjendjes së llojeve të rralla apo të rrezikuara, kërkon një analizë serioze, pasi të punohet në terren[20]. Nga aspekti floristik deri tani janë konstatuar 139 asociacione bimore të grupuara në 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasë (Rexhepi, F. 1994)[21].
Nga hulumtimet e deri tashme të faunës së Kosovës, dihet për 210 lloje të egra të kurrizorëve, pakurrizorët janë pak të hulumtuar (dihet për 200 lloje të fluturave dhe për 400 takson të makrobentosit të ujërave.
Qendrat më interesante të biodiversitetit të Kosovës janë: Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Pashtriku, Korintiku, Mokna, etj.
Mbrojtja e botës shtazore në Kosovë deri më sot është e rregulluar sipas Ligjit ende në fuqi mbi gjuetinë[22].
Sipas ketij Ligji mbrohen vetëm

Grafikoni 6. Numri i llojeve endemike të flores vaskulare të Kosovës në kuadër të numrit të përgjithshëm të llojeve të evidentuar në Kosovë



[19] Flora e Ballkanit llogaritet të ketë mbi 7000 lloje të bimëve vaskulare (Polunin, O. 1997)

[20] Deri tani IMNK disponon me një listë prej 27 llojeve të propozuara për vënje nën mbrojtje ligjore që nga viti 1986, një listë e cila mendojmë se nuk është reale dhe duhet të revidohet pasi të bëhen analiza hulumtuese profesionale në terren.

[21] Numri i asociacionev mendojmë se do të ndryshn pozitivisht, kur i marrim në konsiderim se hulumtimet janë në vazhdimësi.

Tabela 7. Disa lloje bimore që konsiderohen të rralla dhe të rrezikuara në Kosovë

1.	Bershei i rëndomtë / *Taxus baccata L.*
2.	Bujgeri / *Quercus trojana Webb.*
3.	Vidhi i rëndomtë / *Ulmus campestris L.*
4.	Panja malore / *Acer heldreichii Orph.*
5.	Boshtra / *Forsythia europea Deg. Et Bald.*
6.	Vulfonia / *Wulenia carinthiaca Jack.*
7.	Tulipani i Sharrit / *Tulipa scardica Bornm.*
8.	Troliusi / *Trollius europeus L.*
9.	Zambaku / *Lilium albanicum Gris.*
10.	Karafili i Sharrit / *Dianthus scardicus Wetst.*
11.	Kurorezë / *Fritillaria graeca Boiss. Et Sprun.*
12.	Bathra / *Narcissus poeticus L.*
13.	Lepjeta / *Rumex balcanicus Roth.*
14.	Asheja / *Ilex aquilifolium L.*
15.	Xerxelja / *Daphne blagayana Freyer.*
16.	Ramonda / *Ramonda serbica Pančič.*
17.	Bozhuri dekorativ / *Paeonia decera Anders.*
18.	Bozhurea koraline / *Paeonia corallina Retz.*
19.	Valdestenia / *Waldesteinia geoides Willd.*
20.	Poligala / *Polugala dorfleri Hayek.*
21.	Moltkea / *Moltkea doerfleri Wettst.*
22.	Dioskora / *Dioscorea balcanica Koshan.*
23.	Rododendroni / *Rhododendron ferrugineum L.*
24.	Sanëza e verdhë / *Gentiana lutea L.*
25.	Draba / *Draba korabensis Kum, et Deg.*
26.	Ylli i Alpeve / *Leontopoodium alpinum Casa. Var. nivele (Ten.) D. C.*
27.	Asteri i Shqipërisë / *Aster albanicus Deg.*

kurrizorët e lartë si shpendët dhe gjitarët edhe atë në tri forma të mbrojtjes:

Llojet në mbrojtje të përhershme: këtu hyjnë 6 lloje gjitarësh dhe përfaqësuesit e 15 familjeve të shpendëve. Në këte grup hyjnë lloje të rralla dhe të rrezikuara si rrëqebulli (Lynx lynx), dreri (Dama dama), gjeri i madh (Glis glis), lundërza (Lutra lutra), shqiponja e maleve (Aquila Chrysaetos), shqiponja perandorake (Aquila heliaca), lejleku i bardhe Ciconia ciconia) etj.

Llojet në mbrojtje të përkohshme: gjenden 12 lloje gjitaresh dhe 26 lloje shpendësh. Këto lloje janë të mbrojtura në periudha të caktuara kohore gjatë vitit, kur edhe në atë kohë ndalohet gjuetia ndaj tyre. Këtu hyjnë: kaprolli (Capreolus capreolus), dreri (Cervus elaphus), dhia e egër (Rupicapra rupicapra), ariu i murrmë (Ursus arctos), pula e egër (Tatrao urogallus), thëllëza gurore (Alectoris graeca), etj.

Llojet e shpendëve këngëtarë dhe llojet e shpendëve dhe gjitarëve të rëndësishëm për bujqësi dhe pylltari, si dhe llojet e rralla dhe të rralluara që nuk janë për gjueti. Në këtë grup bëjnë pjesë: iriqi (Erinaceus europaeus), rendi i lakuriqëve (Chiroptera), dallëndyshet (Hirundinidae), qukapikët (Piccidae), harabelat (Passeridae), etj.

Llojet që janë të pambrojtura dhe mund të gjuhen në çdo kohë, janë: ujku (Canis lupus), dhelpra (Canis vulpes), çakalli (Canis aureus), etj.

Ndërsa në vitin 2003 nga MMPH si lloje raritet, të rralla, të rralluara dhe të rrezikuara të gjitarëve në Kosovë janë shpallur rreptësisht të mbrojtur këto lloje[23]:



Kaprolli (Capreolus capreolus)

[22] Ligji i Kosovës për Gjuetinë ("GZK" 22/73, 37/79, 14/ 87)

23 Vendimi i MMPH-së, të datës 23 maj 2003

Tabela 8. Ilojet e mbrojtura te gjitarëve të rrallë dhe të rrezikuar

1	Ariu i murrëm (*Ursus arctos),*
2	Rrëqebulli (*Lynx lynx),*
3	Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra),*
4	Kaprolli (*Capreolus capreolus),*
5	Macja e egër *(Felis sylvestris),*
6	Dreri (*Cervus elaphus),*
7	Ketri (*Scirius vulgaris),*
8	Kunadhja e artë *(Martes martes*),
9	Kunadhja e bardhë *(Martes foina)* dhe
10	Gjeri i lajthive (*Muscardinus avellanarius).*

Grafikoni 7. Shpendët e Sharrit dhe shkalla e rrezikimit sipas IUCN



Tabela 9. Numri llojeve të shpendëve në Sharr dhe statusi i rrezikimit sipas IUCN, LKSH dhe LKGj[24]

EMRI SHKENCOR	EMRI NË SHQIP	IUCN	LKSH[25]	LKGj[26]
ACCIPITRIDAE				
Aquila chrysaetos	*Shqiponja e maleve*	LR		1
Aquila heliaca	*Shqiponja perandorake*	EN	E	1
Circaetos gallicus	*Shqiponja e gjarpërinjëve*	VU		1
Nephron percnopterus	*Seronio i bardhë*	VU		1
Buteo buteo	*Shqiponja minjëngrënëse*	LR		1
Buteo rufinus	*Huta bishtbardhë*	LR	K	1
Pernis apivoris	*Huta grenxangrënëse*	LR	K	1
Hieraetus fasciatus	*Shqiponja bishtvizuar*	CR	I	1
Hieraetus pennatus	*Shqiponja e vogël*	EN	E	1
Accipiter gentilis	*Gjeraqina*	LR	V	2
Accipiter nisus	*Gjeraqina?*	LR		2
Accipiter brevipes	*Gjeraqina këmbëshkurtër*	VU	R	1
Milvus milvus	*Huta bishtgërshërë e kuqrreme(kaqabeti)*	CR	R	1
Milvus migrans	*Huta e zezë bishtgërshërë*	VU	R	1
Gyps fulvus	*Shkaba(coftinari kokëbardhë)*	VU	R	1
Aegypius monachus	*Shkaba e zezë*	EX	K	1
Gypaetos barbatus	*Shkaba mjekëroshe*	EX	E	1
Circus cyaneus		VU		1
Circus macrourus	*Shqipja e stepave*	NE	I	1
Circus pygargus	*Shqipja e balltaqeve*	VU	R	1
FALCONIDAE				
Falco peregrinus	*Skifteri i përhimë*	VU		1
Falco subbuteo	*Skifteri i dallëndysheve*	LR		1
Falco biarmicus	*Skifteri i mesdheut*	EN	K	1
Falco vespertinus	*Skifteri këmbëkuq*	VU	R	1
Falco naumanni	*Fajkoi thonjëbardhë*	CR		1
Falco tinnunculus	*Fajkoi i kuq*	LR		1
PHASIANIDAE				
Tetrastes bonasis	Pula e pyjeve		E	2
Alectoris graeca	Thëllënza gurore	VU		2
Perdix perdix	Thëllënza fushore	LR		2
Coturnix coturnix	Shkurtëza	LR		2
Phasianus colchius	Fazani	NE		2
Tetrao urogallus	Pula e egër e madhe	EN	V	2
CHARADRIDAE				
Eudromias morinellus				2
Vanellus vanellus		LR		2
SCOLOPACIDAE				
Tringa hypoleucos				1
Scolopax rusticola	Pulëdushku	VU		2
LARIDAE				
Larus ridibundus	Pulëbardhë	LR		1
Larus argentatus		LR		1
COLUMBIDAE				
Columbo livia	Pëllumbi i egër i shpellave	EN		2
Columbo oenas	Pëllumbi i egër i zgavrrave	LR		
Columbo palumbus	Pëllumbi kreshtor	LR		2
Streptopelia decaocto	Kumria	LR		1
Streptopelia turtur	Turtullesha	VU		2

24 Studime Gjeografike, Nr. 14. Akademia e shkencave dhe Arteve të Shqipërisë, 2002

25 Libri i Kuq i Shqipërisë: E-lloji në rrezik zhdukje;V-lloji i keqësuar;R-lloji i rrallë;I-lloji me status të papërcaktuar;K-lloji i njohur pam-jaftueshëm.

26 Ligji i Kosovës për Gjuetinë: 1-lloji në mbrojtje të përher-shme; 2-lloji në mbro-jtje të përkohshme;3-lloje të rralla dhe të rëndësishme

CUCULIDAE				
Cuculus canorus	Qyqja	LR		3
STRIGIDAE				
Otus scops	Huti i vogël	LR		1
Bubo bubo	Huti i madh(bufi)	VU	V	1
Asio otus		LR		1
Athene noctua	Kukuvajka	LR		1
Strix aluco	Huti i pyjeve	LR		1
Strix uralensis	Huti i uralit	LR		1
Glaucidium passerinum	Kukuvajka e vogël	VU	I	1
TYTONIDAE				
Tyto alba	Kukuvajka	VU		1
CAPRIMULGIDAE				
Caprimulgus europeus	Dallëndyshja e natës(shpatorja)	VU		3
APODIDAE				
Apus apus	Dejka	LR		3
Apus mebla	Sorra e madhe	LR		3
ALCEDINIDAE				
Alcedo athis	Sqepgjata peshkatar(nori)	LR		3
UPUPIDAE				
Upupa epops	Pupëza	LR	R	3
MEROPIDAE				
Merops apiaster	Bletari	LR		3
CORACIDAE				
Coracias garrullus	Korbi i artë	LR	R	1
PICIDAE				
Dryocopus martius	Qukapiku i zi	VU		3
Picus canus	Qukapiku i përhimë	VU	R	3
Picus viridis	Qukapiku i gjelbër	VU		3
Dendrocopos syriacos	Qukapiku sirian	LR		3
Dendrocopos major	Qukapiku i madh laraman	LR		3
Dendrocopos medius	Qukapiku mesatar	LR		3
Dendrocopos leucotos	Qukapiku laraman i pyllit	VU		3
Dendrocopos minor	Qukapiku i vogël	LR		3
Picoides tridactylus	Qukapiku me tre gishta	VU		3
Junx torquilla	Qafëdredhësi	VU	R	3
ALAUDIDAE				
Eremophila alpestris	Laureshe me brirë	VU	I	3
Caladrella cinerea				3
Melanocorypha calandra	Laureshë e madhe	EN		3
Lullula arborea	Laureshë e pyjeve	VU		3
Galerida cristata	Laureshe me kaqubëz	VU		3
Alauda arvensis	Laureshe e fushës	VU		3

CINCLIDAE				
Cinclus cinclus	Mullinja e ujit	LR		3
TROGLODYTIDAE				
Troglodytes troglodytes	Cicamiu	LR		3
PRUNELLIDAE				
Prunella modularis		LR		3
Prunella collaris	Dredhësi i alpeve	LR	R	3
SYLVIDAE				
Sylvia communis	Kaqubari gushan	VU		3
Sylvia curruca	Kaqubari	LR		3
Sylvia atricapilla	Kaqubari kokëkuq	LR		3
Phyloscopus collybita	Fishkëlluesi i thjeshtë	LR		3
Phylloscopus sibilatrix	Bilbili pyjor	LR		3
Phylloscopus bonelli	Fishkëllënjes gushëbardhë	VU	R	3
MUSCICAPIDAE				
Muscicapa striata	Mizëngrënësja e përhimë	LR		3
Ficedula hypoleuca	Mizëngrënësja e larme	LR		3
Ficedula albicollis	Mizëngrënësja qafëbardhë	VU	R	3
Ficedula parva	Mizëngrënësja e vogël	VU		3
TURDIDAE				
Saxicola torquata	Barishtorja kokëzezë	VU		3
Saxicola rubetra	Barishtorja e rëndomtë	LR	I	3
Monticola solitarius		VU		3
Monticola saxatilis	Mullibardha e egurëve	LR	K	3
Oenanthe oenanthe	Bardhoshja e rëndomtë	LR		3
Oenanthe hispanica	Bardhoshja mediteranike	VU	R	3
Phoenicurus ochruros	Bishtkuqja e zezë	LR		3
Phoenicurus phoenicurus	Bishtkuqja e rëndomtë	EN	V	3
Erithacus rubecula	Gushëkuqi	LR		3
Luscinia megarhynchos	Bilbili i randomët	LR		3
Turdus merula	Mëllinja e zezë	LR		3
Turdus torquatus	Mullizeza malore	LR	R	3
Turdus pilaris	Mullibardha	LR		3
Turdus philomelos		LR		3
Turdus viscivorus	Mullibardhe	LR		3
AEGITHALIDAE				
Aegithalos caudatus	Trishtili bishtgjatë	LR		3
PARIDAE				3
Parus ater	Trishtili i bredhit	LR		3
Parus major	Trishtili i madh	LR		3
Parus caeruleus	Trishtili i kaltër	LR		3
Parus cristatus	Trishtili buzaq	VU		3
Parus montanus	Trishtili kokëzi	LR	R	3
SITIDAE				
Sita euro pea	Sqepadri	VU		3
TICHODROMADIDAE				
Tichodroma muraria	Zvarritësi krahëkuq	LR	R	
CERTHIIDAE				
Certhia familiaris		LR		3
Certhia brachydactyla		LR		3
REMIZIDAE				
Remiz pendulinus	Cinka e bardhë(kolovatësi)	LR	R	
ORIOLIDAE				
Oriolus oriolus	benga	LR		3
LANIIDAE				
Lanius excubitor	Larashi i madh i përhimë	LR	V	3
Lanius collurio	Larashi kurrizkuq	VU		3

CORVIDAE				
Garrulous glandarius	Sojka,grifsha	LR		2
Nucifraga caryocatctes	Gala e lajthive(arrathyes)	VU	R	1
Pica pica	Laraska	R		
Pyrrhocorax pyrrhocorax	Stërqoka sqepkuqe	EN	R	1
Corvus corax	Korbi	LR		1
Corvus frugilegus	Korbi sqepbardhë	LR	R	1
Corvus cornix	Korbi i bardhë	LR		1
Corvus monedula	Gala,sorra,qava	VU		
STURNIDAE				
Sturnis vulgaris	Gargulli			3
PASSERIDAE				
Passer montanus	Harabeli i malit	LR		3
Passer hispaniolensis	Harabeli spanjoll	VU		3
Passer domesticus	Harabeli shtëpiak	LR		3
Petronia petronia	Harabeli i gurëve	EN	R	3
FRINGILLIDAE				
Fringilla monTifringilla	Borsi	LR		3
Fringilla coelebs	Borsi i rëndomtë	LR		3
Carduelis carduelis	Feraku	LR		3
Carduelis chloris	Verduni	LR		3
Carduelis spinus	Cerla dimërake	VU		3
Pyrrhula pyrrhula	Gushëkuqi	LR	R	3
Cocothraustes cocothraustes	Sqeptrash	LR	V	3
Acanthis cannabina				3
Serinus serinus	Kanarinë e verdhë	LR		3
Loxia curvirostra	Sqepkryqi	LR		3
EMBERIZIDAE				
Emberiza calandra	Cerla e zakonshme	LR		
Emberiza cia	Fuga malore	VU		
Emberiza citrinella	Fuga verdhoshe	LR		
Emberiza cirlus	Fuga gushëzezë	LR		
Emberiza melanocephala		VU		
Emberiza hortulana	Cerla e kopshtit	VU	R	

Tabela. 10. Numri i përafërt i disa llojeve në Kosovë ne raport me ato në Shqipëri , Evropë dhe në botë, sipas grupeve kryesore

Grupi	Lloje në Kosovë	Lloje në Shqipëri	Lloje në Evropë	Lloje në Botë
Baktere	X	X	X	>4,000
Viruse	x	X	X	>5,000
Protozoare	x	X	X	>40,000
Alga	x	600	X	>40,000
Kërpudha	104*	800	16,000	>70,000
Fierna	X	45	145	>12,000
Briofite	X	500	10,000	>14,000
Likene	X	400	1,200	>17,000
Bime me lule	X	3,200	11,415	250,000
Molusqe	x	520 (700)	x	80,000
Insekte	129*	4,000 14,000)	40,000	1,000,000
Krustace dekapode	X	115	150 (Adriatik)	8,000
Ekinodermate	x	46	94 (Mesdhe)	5,650
Peshq te ujërave te ëmbla	8	64	x	8,500
Amfibe	14	15 (16)	62	4,000
Reptilë	14	36 (38)	123	6,500
Shpendë	154*	323 (335)	450	9,881
Gjitarë	45	71 (84)	200	4,327
* : supozohet për numër më të madh të llojeve **x** : numër i panjohur				



Aconitum pentheri, lloj stenoendemik dhe mjekësor (Alpet Shqiptare - Koprivnik, 2004)

Disa lloje bimore dhe shtazore, karakteristike për Kosovën



Aristolochia merxmuelleri(Mirushë, 2003)



Convolvulus cochlearis (Guranë, 2004)



Tulipa scardica (Mirushë, 2002)



Aster albanicus subsp. Albanicus (Mirushë, 2002)



Euphorbia myrsinites (Panorc, 2003)



Forsythia europaea (Mirushë, 2003)



Genista hassertiana (Mali Drenicë, 2004)



Linum flavum (Mali Drenicë, 2004)



Moltkea doerfleri (Mirushë, 2003)



Narthecium scardicum (Gjeravicë, 2003)



Paeonia decora (Mirushë, 2003)



Centaurea kosaninii (Gubavc, 2004)



Euphorbia glabriflora (Mirushë, 2003)



Halacsia sendtneri (Mirushë, 2002)





Veronica andrazovszkyi (Guranë, 2004; Mirushë, 2003)



Telekia speciosa (Malet e Sharrit, 2004)



Arcethobium oxycedri (Mirushë, 2003)



Echinops sphaerocephalium L. subsp. Albidus (Mirushë, 2004)



Amygdalus nana L. ëPrunus tenella](Gllarevë, 2004)



Myriaphyllum verticillatum (Blinajë, 2004)



Adonis vernalis (Mirushë, 2004)



Pinus mugo (Koprivnik, 2004)



Pinus peuce (Koprivnik, 2004)



Quercus trojana (Reqan, 2004)



Convolvulus althaeoides (Mirushë, 2003)



Cornus mas (Mali Drenicë, 2004)



Crataegus monogyna (Mali Drenicë, 2004)

III.



Ariu i murrëm (Ursus arctos Linn.)
foto IMNK 2004



Rrëqebulli (Lynx lynx Linn.)



Kaprolli (Capreolus capreolus Linn.)
foto IMNK 2004



Dhia e egër (Rupicapra rupicapra Linn.) nga Bjeshkët e Nemuna, foto Fatos Lajçi,



Dhelpra (Vulpes vulpes), 2005



Pulegra e madhe (Tetrao urogallus)



Vipera sp (Mirushë, 2003)



Testudo sp. (Reqan, 2004)

V. SHTOJCAT

Kategoritë e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura sipas IUCN

IUCN (The World Conservation Union) – Unioni ndërkombëtar për konzervimin e natyrës është themeluar më 1948 dhe grupon organizata qeveritare, organizata joqeveritare, institucione shkencore dhe agjencione për konzervim nga 120 vende. Objektivat e Unionit janë të përparojë dhe mbështesë mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve të gjalla.

Kategoria I. Rezervë Strikte Natyrore / Rezervat shkencor/
Përgjithësisht janë zona të vogëla pak ose aspak të shqetësuara nga njeriu që ruhen dhe menaxhohen për qëllime shkencore dhe mbrojtjen e botës së gjallë.

Kategoria II. Park Kombëtar
Përgjithësisht janë zona të gjera që ruhen dhe menaxhohen për mbajtjen e ekosistemeve, edukim dhe rekreacion (shlodhje, argëtim).

Kategoria III. Monument Natyre
Zonë me përmasa të vogla që mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore ose historike.

Kategoria IV. Zonë e Menaxhimit të Habitateve dhe Llojeve / Reservat Natyror i Menaxhuar/
Zonë e mbrojtur për ruajtjen e llojeve dhe habitateve përmes një menaxhimi të përshtatshëm.

Kategoria V. Peizazhe të mbrojtura tokësore dhe detare
Zonë e mbrojtur dhe e menaxhuar kryesisht për mbrojtjen e peizazheve dhe për rekreacion (shlodhje, argëtim). Kjo kategori përfshin pjesë toke/deti në pronësi publike ose private dhe qendra banimi, brënda të cilave zhvillohen aktivitete, si bujqësia, pemëtaria, pylltaria, peshkimi etj. Qëllimi është që të ruhet cilësia e peizazheve dhe bashkveprimi harmonik i aktivitetit të njeriut në to, si dhe diversiteti biologjik që ato përmbajnë.

Kategoria VI. Zonë e mbrojtur e Resurseve të Menaxhuar /Rezervë e Resurseve/
Zonë e mbrojtur dhe e manaxhuar për një përdorim të qëndrueshëm të resurseve natyrore.

Kategoritë botërore të rrezikimit të llojeve

Shkallët e rrezikimit të llojeve bimore dhe shtazore janë të përcaktuara nga IUCN-së (Unionit Botëror për Ruajtjen e Natyrës.) Klasifikimi i tillë njeh kategoritë e mëposhtme të rrezikimit të taksoneve.

Lloji/takson i zhdukur (Ex)
Kjo kategori përmbledh lloje/taksone që kanë ekzistuar më pare në natyrë në vendin tonë, por që tashmë nuk takohen në gjendje spontane

Lloji/takson në rrezik zhdukjeje (E).
Në kët kategori futen lloje/taksone tepër të rrezikuara, popullatat e të cilave janë reduktuar aq shumë sa që llojet/taksonet konsiderohen në rrezik për t'u zhdukur, nëse faktorët që kanë shkaktuar një gjendje të tillë, vazhdojnë të veprojnë.

Lloji/takson i keqësuar (V).
Kjo kategori përfshin lloje/taksone që në të ardhmen priten të futen në kategorinë e llojeve/taksoneve në rrezik zhdukje, nëse faktorët që shkaktojnë reduktimin e popullatave të tyre vazhdojnë të veprojnë. Në këtë kategori futen lloje/taksone popullatat e të cilave janë në pjesën më të madhe të tyre duke u reduktuar për shkak të tejshfrytëzimit, dëmtimit ekstensiv të habitatit të tyre dhe dëmtimeve tjera në mjedis. Gjithashtu, kjo kategori përfshin lloje/taksone me popullata plotësisht të demtuara, mbijetesa e të cilave nuk mund të jetë më e garantuar, si dhe lloje/taksone me përhapje të gjërë, por që ndodhen nën veprimin e faktorëve kërcënues në të gjithë shpërndarjen e tyre.

Lloj/takson i rrallë (R)
Në këtë kategori futen lloje/taksone që takohen në popullata të vogla,që mund të jenë ose jo nën veprimin e faktorëve kërcënues. Këto lloje/taksone kanë shpesh përhapje lokale dhe takohen në habitate të kufizuara. Këtu futen dhe lloje/taksone që takohen rrallë, por që kanë një përhapje të gjërë gjeografike.

Lloji/taxon me status të papërcaktuar (I)
Përfshinë lloje/taksone, statusi i të cilave nuk ka qenë i mundur të përcaktohej. Për këto lloje/taksone ka mendime dhe opinione të ndryshme si në rrezik zhdukje, të keqësuar, të rrallë etj, por nuk ka qenë e mundur futja e tyre në njërën prej kategorive të mësipërme.

Lloji/takson nën shqyrtim(K*)
Në këtë kategori futen lloje/taksone me status në shqyrtim e sipër. Të dhënat e mbledhura mbi statusin e llojit/taksonit nuk mund të lejojnë ende marrjen e një vendimi për statusin e tyre. Në këtë status futen edhe lloje/taksone, statusi i të cilave paraqitet i ndryshuar dhe kërkon të rishqyrtohet dhe rivlerësohet.

Lloji/takson i njohur në mënyrë të pamjaftueshme (K)
Kjo kategori përfshin lloje/taksone që mendohet dhe besohet të jenë të rrezikuara me përkatësi në kategori të ndryshme rrezikimi, por që të dhënat e pakëta dhe të pamjaftueshme rreth gjendjes së tyre, nuk mundësojnë klasifikimin e saktë të tyre.

Lloji/takson i shqetësuar (T)
Në këtë kategori futen lloje/taksone që ndodhen nën veprimin direkt të faktorëve dëmtues, të rëndësishëm që priten të kenë pasoja të rënda dhe të shpejta në popullatat e tyre.

Lloji/takson kandidat (C)
Përfshinë lloje/taksone që deri tash nuk kanë qenë të shqetësuar dhe kërcënuar, por që mund të paraqiten si të tillë në një të afërt. Në këtë kategori futen lloje/taksone të zakonshëm, me një përhapje të gjërë gjeografike, por që në disa pjesë të përhapjes së tyre kanë filluar të rrallohen nën veprimin direkt ose indirekt të faktorëve dëmtues. Mosmarrja e masave mbrojtëse do të bënte që llojet/taksonet e kësaj kategorie të dëmtohen seriozisht dhe të ngjiten në kategori më të larta të rrezikimit.

Akte Ndërkombëtare Mjedisore

Akti ndërkombëtarë mjedisor	Qëllimi	Vendi, viti
Konventa për mbrojtjen e trashëgimisë (thesarit) kulturore dhe natyrore	Ruajtja e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në botë	Paris, 1972
Konventa për ruajtjen e venbanimeve moqalike (ligatinave)	Ruajtja e ligatinave te rëndësishme ndërkombëtare, veqanërisht si habitate te shpëndëve të ujit	Ramsar, 1971
Konventa e Firences	Mbrojtja e Peizazheve Evropiane	Firencë, 2000
Konventa për shumëllojshmërinë biologjike (biodiversitetin)	Ruajta globale e diversitetit biologjik dhe përdorimit me kriter të drejtë të burimeve gjenetike dhe transformimin e nevojshëm të tyre	Rio de Zhaneiro,1992 Nairobi, 1992
Konventa për tregëtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër (CITES)	Bashkëpunimi ndërkombëtarë për mbrojtjen e specieve të caktuara të florës dhe faunës së egër kundër mbishfrytëzimit prej tregtisë ndërkombëtare	Uashington, 1973
Konventa e Barcelonës	Mbrojtja e mjedisit detarë dhe zonës bregdetare të Mesdheut	Barcelonë , 1976
Konventa e Bonit	Mbrojtja e specieve shtegtuese të kafshëve të egra	Bon,1979
Konventa e Bernës	Ruajtja e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës	Bern, 1979
Konventa e mbi ndotjen atmosferike në distance të mëdha	Mbrojta e atmosferës nga ndotësit që përhapen në distance të mëdha	Gjenevë,1979 Gjenevë,1984 Oslo,1994 Aarhus,1998
Konventa e ESPOO-s	Vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontestet ndërkufitar	Helsinki, 1991
Konventa mbi mbrojtjen e rrjedhave ujore ndërkufitare dhe liqejve ndërkombëtarë	Mbrojta dhe përdorimi i drejtë i rrjedhave ujore dhe liqejve ndërkombëtarë	Helsinki, 1992
Konventa për mbrojtjen e shtesës së Ozonit	Mbrojta e shtesës së Ozonit nga gazrat dhe ndotësit industrial	Viena, 1989
Konventa kornizë e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike	Mbrojta e atmosferes nga ndryshimet kilmatike	Nju Jork, 1992
Konventa e Bazelit	Kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme, sistemimi dhe asgjësimin e tyre	Basel, 1989
Konventa e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër shkretëtirizimin dhe thatësisë	Lufta kundër shkretëtirëzimit dhe thatësisë në ato vende që e kanë kaluar thatësinë serioze dhe shkretëtirëzimin	Paris, 1994
Konventa per mbrojtjen e Detit te zi	Mbrojtja e Detit të zi nga ndotja	Bukuresht,1992
Konventa mbi pasojat ndërkufitare të havarive industriale	Mbrojtja nga pasojat e havarive nderkufitare industriale dhe tejkalimi i tyre	Helsinki, 1992

Konventa mbi detyrimet civile për mjedis	Detyrimet civile për dëmtimet e shkaktuara nga aktivitetet e rrezikshme për mjedis	Lugano,1993
Konventa për mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të lumit Danub	Bashkëpunimi i vendeve nënshkruese për mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të lumit Danub	Sofia , 1994
Konventa e Aarhusit	E drejta e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin	Aarhus, 1998
Marëveshje mirëkuptimi për mbrojtjen e shpezëve shtegëtuese Afrikane dhe Euroaziatike	Mbrojtja e llojeve të shpendëve moqalike shtegtare Afrikane dhe Euroaziatike	Bonn,1996
Marrëveshje mirëkuptimi ACCOBAMS	Mbrojtja e Balenave (Cetacea), në Detin e Zi, Detin Mesdhe dhe në territorin fqinjësor të Atlantikut	Monako,1996
Marrëveshje mirëkuptimi për mbrojtjen e lakuriqëve në Evropë	Mbrojtja e llojeve të lakuriqëve në Evropë	Londër, 1991
Marëveshja për mirëkuptim lidhur me masat për mbrojtjen e llojit Numenius Tenuirostris	Mbrojta e llojit të shpendit shtegtar Numenius Tenuirostris	1995
Memorandumi për mirëkuptim për mbrojtjen e llojit Otis Tarda	Mbrojtja e popullacioniut të Pulegrës së madhe (Otis Tarda) në Evropë	…,2000
Protokoli për sigurinë biologjike	Siguria Biologjike në suza të Konventës mbi shumëllojshmërinë biologjike	Montreal (Kartagjena), 2000
Protokolet për mbrojtjen e territorit të Detit Mesdhe	Mbrojta e mjedisit të Detit Mesdhe nga ndotësit e natyrave të ndryshme në raste rreziku	Barcelonë,1976 Athinë,1980 Gjenevë,1982 Madrid ,1994 Izmir,1996
Protokoli i Kjotos	Limitimi i lirimit të gazrave qe ndikojn ne shtresen e Ozonit	Kyoto, 1997
Protokoli mbi metalet e rënda	Mbrojtja e mjedisit nga metalet e rënda	Aarhus, 1998
Direktiva e EU-së për ruajtjen e shpendëve	Mbrojtja dhe ruajtja e llojeve të shpendëve në kuadër të Bashkimit Evropian	Bruksel,1979
Direktiva për mbrojtjen e venbanimeve natyrore të florës dhe faunës së egër	Mbrojtja dhe ruajtja e venbanimeve natyrore të florës dhe faunës së egër	1992

5 4. Kalendari Mjedisor	
02 Shkurt:	Dita Ndërkombëtare e Ligatinave (Tokave të Lagura).
05 Mars:	Dita Botërore e Efiçencës së Energjisë.
15 Mars:	Dita Ndërkombëtare e Konsumatorit.
22 Mars:	Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Ujit.
23 Mars:	Dita Botërore e Metereologjisë.
24 Mars:	Dita Europiane e Parqeve.
07 Prill:	Dita Botërore e Shëndetit - "Fëmijët dhe Mjedisi".
22 Prill:	Dita Ndërkombëtare e Tokës.
24 Prill:	Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve Laboratorike.
15 Maj:	Dita Ndërkombëtare e Ndryshimeve Klimatike.
22 Maj:	Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit.
31 Maj:	Dita Botërore kundër Duhanit.
05 Qershor:	Dita Botërore e Mjedisit.
08 Qershor:	Dita Botërore e Oqeaneve.
17 Qershor:	Dita Botërore e Luftës kundër Shkretëtirizimit.
21 Qershor:	Dita e Liqenit të Ohrit.
11 Korrik:	Dita Botërore e Popullsisë.
18 Gusht:	Dita Ndërkombëtare e Gjeologjisë.
26 Gusht:	Dita Botërore e Maleve të Pastra.
16 Shtator:	Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Ozonit.
22 Shtator:	Dita Botërore e Qyteteve të Pastra.
04 Tetor:	Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve.
06 Tetor:	Dita Botërore e Habitateve.
08 Tetor:	Dita Ndërkombëtare për Pakësimin e Shkatërrimeve.
15 Tetor:	Dita Ndërkombëtare e Ecjes në Natyrë.
16 Tetor:	Dita Botërore e Ushqimit.
17 Tetor:	Dita Ndërkombëtare për Zhdukjen e Varfërisë.
31 Tetor:	Dita Ndërkombëtare e Detit të Zi.
08 Nëntor:	Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane.
11 Dhjetor:	Dita Ndërkombëtare e Maleve.

VI. LITERATURA

1. Arkivi i IKMN-së (-2004): Dokumentet dhe aktvendimet për zonat e mbrojtura, nga arkivi i IKMN_së.
2. Blecic, V., Krasniqi, F. (1971): Zajednica endemicnog sibljaka forzicije i krtusca (Polygalo – Forsythietum europaea) u Jugozapadnoj Srbiji. Glas. Repub. Zav. Zas. Prir. Muz., Titograd.
3. Blecic, V., Tatic, B., Krasniqi, F. (1969): Tri endemicne Zajednice na serpentinskoj podlozi u Srbiji. Acta Bot. Croat. XXVIII: 43 – 47, Zagreb.
4. Çavolli, R. (1997): Gjeografia regjionale e Kosovës, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, .
5. EKMN (1975): Natyra e Kosovës, publikim për Bjeshkët e Nemuna, Enti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës, Prishtinë.
6. EKMN (1982): Arsyeshmëria shoqërore e shpalljes së pjesës së Malit Sharr në Kosovë për Park Nacional,Prishtinë,
7. EKMN (1985): Studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së një pjese të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional, Prishtinë.
8. Grup autorësh (1995): Gjeografia e Kosovës 8, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, .
9. Grup autorësh (1997): Raport profesionalë - shkencor mbi hulumtimet(1995- 1996) në Bjeshkët e Nemuna për Park Nacional, EMNS, Beograd.
10. GZK. 11/86 (1986): Ligji për Parkun Nacional "Mali Sharr" GZK. 11/86, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë
11. GZK. 22/73, 37/79, 14/87 (1973, 1979, 1986): Ligji i Kosovës për gjuetinë.
12. Hundozi, B. (1987): Salvio – Scorsoneretum villosae. Bul. Pun. Sh. I FSHMN, Prishtinë.
13. IUCN (1996): Red List of Threatened Animals,
14. IUCN- 1990 (1990): United Nations List of National Parks and Protected Areas,
15. Krasniqi, E. (2003): Flora vaskulare e rajonit të Mirushës, Punim i magjistraturës, UP, FSHMN, Prishtinë.
16. Maloku, Sh. (1994): Kosova (tersi e lashtë gjeopolitike) Prishtinë.
17. Millaku, F. (1999): Flora subalpike dhe alpine e Alpeve Shqiptare (Kosovë), disertacion I doktoratures UP- FSHMN, Prishtinë

18. Mustafa,B., Hoxha, E. Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2003.
19. Rexhepi, F. & Krasniqi, E. (2004): Real Condition of stenoendemic species Aristolochia merxmuelleri Greuter et E.Mayer 1985 after NATO bombing in Kosovo war of 1999, Hacquetia 3/1, Ljubljana
20. Rexhepi, F. (1983): Subalpska i alpska flora, vegetacija Osljaka i problemi njene zastite, Novi Sad.
21. Rexhepi, F. (1985/86): Flora e Lubotenit (Malet e Sharrit – Kosovë), Natyra e Kosovës, Prishtinë.
22. Rexhepi, F. (1986): Flora e Maleve të larta të Kosovës, ETMMK, Prishtinë.
23. Rexhepi, F. (1994): Vegjetacioni i Kosovës (1), UP, FSHMN, Prishtinë.
24. Rreg. 2003/9 (2003): Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit,
25. Sherifi, Y., Mustafa,B. (2002):Disa veçori të faunës së Malit Sharr, Studime Gjeografike, Nr. 14. Akademia e shkencave dhe Arteve të Shqipërisë,
26. Sherifi, Y., Mustafa,B. (2004): Vështrim i shkurtër i faunës së Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Lindore shqiptare), Studime Gjeografike, Nr. 15. Akademia e shkencave dhe Arteve të Shqipërisë,
27. Shoqata e Ekologëve të Kosovës (2002): Biodiversiteti i Gërmisë, vlerat dhe rreziqet që e kërcënojnë, publikim, Prishtinë
28. ShRMMNSh, ShRShGjSh, ShBSh (1997): Libri i kuq i Shqipërisë, Tiranë,
29. Veselaj, Z., Sherifi, Y. (2001): Llojet e rralla bimore dhe shtazore të Kosovës, publikim Ekoklina & IMNMK, Prishtinë,
30. Veselaj Z. "Mykoflora në disa masive pyjore të Kosovës (Gërmi dhe Mirushë)- studim sistematik, fitogjeografik dhe ekologjik" , Disertacion Universiteti i Tiranës 2004

VLERAT E TRASHËGIMISË NATYRORE TË KOSOVËS

Dizajnimi:
Design House, Prishtinë

Lektor:
Mustafë Mustafa

Ballina :
Burimi i Drinit të Bardhë
Foto: Muhamer Ibrahimi - Trimi

Tirazhi:
1000 copë

U shtyp në Shtypshkronjën:

PRISHTINË
2005